



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 17.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”” (*komision përgjegjës*) me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zonjën Lindita Nikolla. Miratimi në parim i projektligjit.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Ilir Beqaj (zëvendësues), Besnik Baraj (zëvendësues) dhe Anduel Xhindi (zëvendësues).

Mungojnë:

Fate Velaj dhe Vilma Bello.

Të ftuar:

Lindita Nikolla – Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Besa Shahini – Zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Zamira Gjini - drejtore e Përgjithshme për Politikën dhe Zhvillimin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Gerti Janaqi - drejtor i Institutit të Zhvillimit të Arsimit,
Erzen Tola – drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator,

Mariglen Mërtiri - këshilltar i ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Jetlir Gjergji – këshilltar i ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Majlinda Agolli – përfaqësuese e Fondit të Zhvillimit Shqiptaro-Amerikan,
Jonida Lamaj - përfaqësuese nga Fondit të Zhvillimit Shqiptaro-Amerikan.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi- Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Sot në rendin e ditës është diskutimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Të pranishëm në komision kemi ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zonjën Lindita Nikolla; zëvendësministren, zonjën Besa Shahini; zonjën Zamira Gjini, drejtore e Përgjithshme për Politikën dhe Zhvillimin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; zotin Gerti Janaqi, drejtor i Institutit të Zhvillimit të Arsimit; zotin Erzen Tola, drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator; zotin Mariglen Mertiri, këshilltar; zotin Jetlir Gjergji, këshilltar, si dhe dy përfaqësues nga Fondi i Zhvillimit Shqiptaro-Amerikan, të cilët janë të ftuar nga ministria.

Në fakt, para se ta hapim mbledhjen, meqenëse nuk marrim dot pjesë në homazhet që po zhvillohen sot në Durrës, dua t’ju ftoj të mbajmë një minutë heshtje për humbjen e jetës së aktorit të shquar, zotit Fadil Hasa.

(Deputetët e komisionit mbajnë një minutë heshtje.)

Faleminderit! I paharruar qoftë!

Zonja Nikolla, faleminderit për prezencën tuaj dhe stafit të ministrisë, gjë që tregon se i keni dhënë seriozitet një çështjeje kaq të rëndësishme sa u përket të gjithë fëmijëve, atyre që ndjekin arsimin profesional, por edhe mbarëvajtjen e këtij arsimi.

Para se t’ju jap fjalën, dua t’ju pyes lidhur me deklaratën e fundit tuajën, nëse ndiheni e turpëruar për atë deklaratë, ku keni mashtruar publikisht për lëshimin e dëftesave për të gjithë fëmijët që ndjekin arsimin parauniversitar. Them: “keni mashtruar”, sepse keni gënjyer për dëftesat dhe ja ku e keni dëftesën, e cila është e gabuar dhe ju e keni mohuar këtë fakt. Një dëftese lirimi, që e kanë denoncuar deputetët e Partisë Demokratike, së cilës, sikurse ju e shihni, i mungojnë numrat, e keni çuar nëpër shkollë. I keni detyruar mësuesit t’i lënë pushimet dhe të vijnë në shkollë, në shkelje të kontratës kolektive të sapofirmosur, dhe më tej i keni urdhëruar që të kthehen mbrapsht të gjitha dëftesat, 35000 dëftesa lirimi, për të cilat dikush duhet të mbajë

përgjegjësi. Po ashtu, keni mashtruar kur keni thënë se dëftesat janë shpërndarë, ndërkohë që neve na kanë ardhur mijëra mesazhe me e-mail dhe në *inboks*, ku mësuesit na njoftojnë se dëftesat do të ndahen në shtator. Pra, unë mendoj se para se të kaloni në diskutimet për ndryshimet e një projektligji, ju, minimalisht, duhet t'u kërkonti ndjesë 420 mijë fëmijëve, që nuk marrin dot dëftesat, nuk shkojnë dot nëpër shkollat e tjera dhe nuk marrin dot transferimin. Duhet t'u kërkonti ndjesë prindërve të tyre, sidomos atyre që nuk mund të rregullojnë fëmijët dhe të bëjnë transferimin brenda ose jashtë vendit. Unë mendoj se do të ishte në dinjitetin tuaj dhe të funksionit që ju kryeni, që minimalisht të bëni një ndjesë publike për prindërit dhe fëmijët.

Ju lutem, mos kërcënoni deputetët e opozitës, sepse jeni ju që keni shpërdoruar detyrën tuaj, duke mos u siguruar dëftesat në kohë 420 mijë fëmijëve!

Fjala për ju.

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Pa dyshim është një moment shumë i rëndësishëm, të cilin ne e adresojmë me seriozitet të plotë, që lidhet me arsimin parauniversitar dhe jo arsimin profesional, sepse nuk jemi mbledhur për arsimin profesional, zonja kryetare e komisionit, por për arsimin parauniversitar, përgjegjësia e së cilës është nën Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

Mungesa e etikës nuk është risi sa herë që ju flisni, përkundrazi, do të çuditësha nëse sjellja do të reflektonte ndoshta ndonjë grimcë etike. Ndaj e përsëris edhe një herë, unë nuk kam arsye të kërcënoj askënd. Kjo nuk është as në etikën dhe as në sjelljen time pa qenë ministre, jo më ministre, ku njeriu adreson edhe më shumë përgjegjësi. I jam drejtuar prokurorisë për një akuzë që më është bërë publike dhe, pa dyshim, do t'i shkoj deri në fund, që histori të tilla, ku shpif e shpif se diçka mbetet, mund të jenë histori të një partie që ka humbur çdo kauzë, por s'mund të jetë historia..

Albana Vokshi – Dëftesat e lirimt.

Lindita Nikolla - ..e njerëzve që punojnë me ndershmëri, me mish dhe me shpirt...

Albana Vokshi – Zoti Beqaj!

Lindita Nikolla - ...për të realizuar gjithçka që kam premtuar.

Edhe një herë e përsëris, meqë nuk e dëgjuat, do të ishte risi të dëgjonim nga ju...

Albana Vokshi – Zonja Ministre, një sekondë, sepse nuk funksionon fonia.

Ju lutem, a mund ta rregulloni foninë?

Kur ndez mikrofonin tim, i fiket zonjës ministre dhe mendoni sikur po ia bëj qëllimisht për të mos folur, por nuk është ashtu, unë thjesht...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju falënderoj shumë për shpjegimin që keni bërë zoti Baraj, por unë mendoj që nëse keni fëmijë...

Të gjitha mesazhet që na kanë dërguar prindërit, presin përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ata njerëz presin përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo do të thotë se unë jam shumë në rregull politikisht, zoti Baraj. Kjo ju shqetëson dhe unë ju kuptoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Na kanë dërguar me mijëra fëmijë....

Ju lutem, shpjegojuni atyre për dëftesat, sepse një pjesë e tyre e kanë të pamundur të marrin dëftesat dhe të transferohen në një shkollë tjetër. Është hera e parë në 27 vjet që fëmijët nuk marrin dot dëftesat, nuk ka ndodhur as në kohëra..

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do t’jua kaloj foninë, vetëm të shpjegoni me shumë qetësi lidhur me dëftesat, sepse marrim mesazhe pa fund nga prindërit.

Lindita Nikolla – E përsëris edhe një herë falënderimin dhe pa dyshim seriozitetin për të adresuar një moment shumë të rëndësishëm që ka të bëjë me projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012.

Zonja kryetare, nuk do të çuditesha nëse ju do ta fillonit ndryshe këtë mbledhje, sepse juve ju karakterizon mungesa e etikës. Ndaj dua t’ju përgjigjem me atë që unë di të bëj gjithmonë, Linditën etike.

Edhe një herë, pa dyshim që do t’u shkoj deri në fund, në organet e drejtësisë, të gjitha akuzave që janë bërë publike karshi meje. “Shpif, shpif se diçka mbetet”, nuk mund të jetë një vijë sjelljeje, që na kalon duke mbyllur sytë dhe veshët. Sigurisht që kjo është vija e vetme sjelljes së një partie që ka humbur çdo kauzë, por nga ne që punojmë me mish e shpirt dhe me ndershmëri për të ndryshuar shumë nga zullumet e bëra, qoftë edhe në sistemin arsimor, sigurisht që kërkohet një sjellje tjetër.

U jam përgjigjur maturantëve që u duhet certifikata dhe diploma për të vijuar studimet jashtë shtetit. Kam komunikuar, falë Zotit, me prindërit, me mësuesit dhe me nxënësit e Shqipërisë, të cilët janë sqaruar dhe mirësuar për problematikën dhe situatën.

Ju sapo gënjyet kur thatë se dëftesat do të shpërndahen në shtator, sepse është një proces që po vijon në të gjitha shkollat e Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem zonjë, a kërkoje përgjigjen time, apo do të flisni ju?!

Albana Vokshi- Ju lutem shumë, mos vazhdoni të gënjeni!

Sa për etikë, nuk po nxjerr emra, sepse ju i pushoni mësuesit nga puna...

Lindita Nikolla- Sapo gënjyet, që i referoheni shtatorit.

Albana Vokshi- ...ja ku janë mesazhet që u kanë dërguar prindërve dhe, për të mos u bërë keq mësuesve, kemi hequr vetëm emrat e prindërve. Ja ku thuhet: “Dëftesat do të ndahen në shtator, pasi nuk kanë ardhur”.

Lindita Nikolla- Zonjë, ato paçavure që ke përpara nuk janë Ministria e Arsimit.

Albana Vokshi –Po kjo paçavure është?!

Lindita Nikolla -Po, edhe ajo.

Albana Vokshi- Zonja Ministre, ne jemi këtu për të sjellë zërin e 420 mijë fëmijëve. Nuk po flasim për maturantët, bëni llogaritë mirë, sepse gjoja keni mbaruar edhe për matematikë, 420 mijë fëmijë janë deri në maturë, zonja Ministre, ja ku i keni! Kam pyetur mikeshën time, e cila ka mamanë mësuese dhe thotë që ua prishën mësueseve pushimet, në shkelje të kontratës, që ju sapo e keni firmosur, pas dy vjetësh, i sollën dhe i kthyen prapë, sepse nuk ka dëftesa. Ju lutem, sigurojuni dëftesat fëmijëve! Nuk mund të vini këtu dhe të kërcënoni opozitën, pasi bëni pazaret tuaja.

Është e papërgjegjshme që tenderi për dëftesat të mos kishte mbaruar 2-3 muaj para. Zonja Ministre, përgjegjësia bie direkt mbi ju. Në vend që të merrni përgjegjësisë, vini këtu dhe kërcënoni opozitë. A e kuptoni se ku jeni?! Nuk e mbuloni dot zullumin dhe korrupsionin tuaj, as mungesën e kompetencës suaj.

Lindita Nikolla – Zonjë, rri e qetë, mos u trishto nga zullumi im. Fëmijët duan dashuri, duan modele, por modeli juaj është më i shëmtuari për çdo fëmijë të rritur në këtë vend. Ndaj, ju lutem, më lini të sqaroj...

Alban Vokshi – Kush mban përgjegjësi për 35000 dëftesa, zonja Ministre, të cilat i çuat nëpër shkolla dhe pastaj u detyruat që t’i ktheni mbrapsht? Kush mban përgjegjësi që fëmijët në klasën e 6 apo të 7 nuk kalojnë dot nëpër shkolla të tjera, sepse nuk marrin dot dëftesat?

Lindita Nikolla – A ka mundësi t’ju sqaroj, sepse edhe nuk merr vesh dhe hiqesh si eksperte; totalisht nuk merr vesh nga i gjithë ky proces.

Albana Vokshi – Unë marr vesh aq sa i duhet një prindi, që na ka sjellë mijëra...

Lindita Nikolla- Do ta sqaroj në prokurori dhe në gjykatë të gjithë këtë çështje. Të lutem, vazhdo me rendin e ditës!

Albana Vokshi- Më vjen keq, por ju sot duhet të ndjeheshit e turpëruar për deklaratën që bëtë, duke mashtruar publikisht. Kanë vërshtuar mesazhet te ne.

Ka pasur deklarata publike të ish-kolegeve tuaja, që s’ marrin dot dëftesat e fëmijëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A keni fëmijë ju?

Ismet Beqiraj – Zonja kryetare, kemi një rend dite, ku duhet të diskutojmë për ndryshimet e projektligjit të arsimit parauniversitar.

Albana Vokshi – Çfarë do t’i sigurosh arsimit parauniversitar, nëse nuk u siguron dëftesat fëmijëve?!

Ismet Beqiraj – Apo e keni si aperitiv para mbledhjes?

Albana Vokshi – A keni fëmijë që ndjekin arsimin publik, apo jo?

Ismet Beqiraj – E di se të dhemb shumë zemra për fëmijët tanë, por fillo me rendin e ditës.

Albana Vokshi –Nuk mundet ministrja, që t’i pëlqejë Kryeministrit, të dalë dhe të shantazhojë opozitën. Nuk mund të mashtrojë!

Kush mban përgjegjësi për 35 mijë dëftesa të kthyera?

Ismet Beqiraj – Të lutem, kthehu në normalitet!

Albana Vokshi- Pse nuk të duket normalitet ky? A keni fëmijë ju, a e kanë marrë dëftesën fëmijët tuaj?

Jemi këtu për të përcjellë shqetësimet e 420 mijë fëmijëve, që sot nuk kanë dëftesa. Sa qytetarë shqiptarë janë sot, të cilët presin përgjigje nga ministrja?

Lindita Nikolla – Po u përgjigjem qytetarëve shqiptarë, edhe juve, zonja kryetare, por kjo është përgjigjja shteruese për këtë çështje. Të gjitha përgjegjësitë e mia do t’i zhvilloj në prokurori dhe në gjykatë.

Albana Vokshi – Shumë mirë bëni që shkoni në prokurori, por, nëse do të kishte prokurori, ju duhet të ishit e para që duhet të kishit shkuar atje.

Lindita Nikolla – Janë 420 mijë fëmijë, që po shohin modelin më të shëmtuar teksa ju flisni.

Albana Vokshi- Ndërsa te ju shohin modelin e vjedhjes dhe të korrupsionit. Ky është ndryshimi midis nesh dhe jush. Ky është modeli që ju serviri: vjedhje, korrupsion, paaftësi dhe mungesë kompetence.

Lindita Nikolla- Zonjë, ju në kokë keni vetëm vjedhjen dhe korrupsionin dhe adresoni tek të tjerët atë që jeni gati ta bëni vetë. Është shumë e trishtë që të përballojmë idenë se ju jeni modeli i gruas në Partinë Demokratike, ndërkohë që kjo parti la në shtëpi ato zonja të nderuara.

Edhe një herë po e përsëris, për dëftesat, certifikatat dhe diplomat e maturantëve, që kanë shprehur vullnetin të studiojnë jashtë shtetit, nuk ka asnjë pengesë, janë shpërndarë dhe janë rimarrë.

Problemit të dëftesës, që deputeti e komunikoi nëpërmjet rrjeteve sociale, unë i jam përgjigjur, madje edhe duke e falënderuar. Ai ishte një gabim teknik, i kapur edhe nga ne, është bërë korrigjimi dhe ka filluar shpërndarja në shkolla.

Albana Vokshi- Kush mban përgjegjësi për këtë?

Lindita Nikolla – Nuk e vendos ti përgjegjësinë. Kur të jesh prokurore dhe gjykatëse, atëherë do të përgjigjem.

Albana Vokshi – A e dini rolin e deputetit?

Lindita Nikolla – Po, patjetër, sepse jam deputete.

Albana Vokshi –Jo, nuk e dini, sepse ky është vendi ku bëhet transparenca. Në deklaratën tuaj keni mohuar se ka dëftesa të bëra gabim.

Lindita Nikolla- Po, sepse në shkolla nuk ka dëftesa të bëra gabim.

Albana Vokshi – Keni gënjyer publikisht.

Lindita Nikolla – Zonjë, po ju sfidoj, gjejini një dëftesë të tillë. Atë e keni bërë vetë me kompjuter. Gjeni një të tillë që ka emrin e një nxënësi, firmën dhe vulën.

Albana Vokshi –Ju lutem, sepse jeni ministre, bëhuni serioze! Si mund të gënjeni kështu?!

Lindita Nikolla – Gjeni një të tillë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Zoti Beqaj, kur bëhet fjalë për tendera, nuk e keni mendjen, por unë po ju them se para se të vazhdojmë diskutimin për projektligjin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po mashtron publikisht përsëri. Si mund të thotë ajo që e kam bërë në kompjuter?! A është ministre apo jo?! Unë këtë dëftesë e kam marrë nga mësuesit.

Lindita Nikolla – Zonjë, duhet ta dini që një letër merr vlerën e një dokumenti të lëshuar kur ka emrin, gjeneralitetet e nxënësit, firmën dhe vulën e shkollës.

Albana Vokshi – Këto janë plotësuar nga mësuesit e shkollave.

Lindita Nikolla – Nuk ka asnjë dëftesë të plotësuar me rendin gabim, asnjë.

Albana Vokshi – Si mund të arrini deri këtu?! Ju duhet të ndiheni e turpëruar për deklaratën që keni bërë!

Lindita Nikolla – Unë nuk mund të turpërohem me turpin tuaj.

Albana Vokshi – Ju sot duhet t’u kërkonit ndjesë 420 mijë fëmijëve dhe prindërve të tyre. Është në nderin tuaj të kërkonti ndjesë, janë gjëra që ndodhin. Kush do ta mbaj koston në buxhet, le ta mbajë.

Lindita Nikolla – Zonjë, po jua përsëris edhe një herë, se çfarë është në nderin tim, jam në gjendje të gjykoj vetë, por për turpin tuaj nuk mund të turpërohem unë. Kështu që, ju lutem, më lini të vijoj me detyrën që kam sot!

Luçiano Boçi – Një minutë, zonja Ministre, sepse debati i dëftesave është bërë midis meje dhe teje, nëpërmjet deklaratës që kam bërë në selinë e Partisë Demokratike, ku ju jeni përgjigjur në formë kërcënuese lidhur me prokurorinë. Në fakt, e mirëpres ftesën tënde që të shkojmë bashkë dhe se kush është denoncuesi do ta gjejmë në prokurori, sepse sapo thatë që nuk është shpërndarë një dëftesë e tillë, ndërkohë që foton ta tregova dhe e postova, me dëshirën e mirë që ju të reflektonit dhe ta ndërronit dëftesën. Nuk ishte vetëm çështje akuze, por nga ana juridike, një dokument i cili shkruhet gabim, nuk është i vlefshëm. Këtë shqetësim të fëmijës tim, por edhe të fëmijëve të tjerë e postova, në mënyrë që ju të reflektonit, por reflektimi juaj, për fatin e keq, ishte ai që ju do i drejtoheni prokurorisë. Jam gati të ikim bashkë sapo të mbarojë mbledhja, por do t’ju tregoj një dokument, që, në fakt, ti ia refuzove Albanës, sepse unë e kam postuar atë, por po ju tregoj *e-mail-in* që drejtoria DAR Durrës u dërgon të gjitha shkollave, sepse sapo thatë që nuk janë plotësuar dokumentet e lirimit të klasës së IX. Ja çfarë thotë *e-mail-i*:

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e regjistruar ajo që ke thënë.

DAR Durrës u dërgon shkollave “Shën Vlash”, Qerret, “Qemal Mici” dhe 77 të tjerëve: “Përsëritet! Nëse jeni në procesin e plotësimit të dëftesave të klasës së IX, të ndërpritet puna deri në një njoftim të dytë, pasi do të riprintohen edhe një herë dëftesat e tërhequra nga ju. Nëse keni shpërndarë dëftesa (thotë që nuk keni shpërndarë dëftesa) ju lutem të gjeni mundësinë t’i mbledhni në shkollë”. Iris Kozeli, sekretare, DAR Durrës”. Ky është *e-mail-i*. Kjo ka lidhje me akuzat tuaja, që akuzat tona nuk qëndrojnë. Unë ju solla këtë fakt, krahas fakteve të tjera, që ju i mohuat. Ndërkohë, akuza ime në deklaratën që bëra kishte të bënte me mosshpërndarjen e dëftesave nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë, duke përjashtuar maturantët, që nuk mund ta merrnin atë shpejt dëftesën, ku theksuam se janë 420 mijë fëmijë që nuk kanë marrë dëftesën. Ky ishte shqetësim real. *E-mail-i* ka datën dhe orën, 11.07.2018, ora 14:34.

Pse i bëra të gjitha këto publike?! I bëra publike që ju të mos fshiheni pas deklaratave, siç ishte prokuroria e të tjerë. Ne shkojmë bashkë në prokurori, sepse edhe sot ju do të bëni një shkelje ligjore shumë të madhe, që e keni bërë përgjatë 5 vjetëve, siç është çështja e portalit, keni bërë edhe shkelje të tjera ligjore, siç është dhënia e programit të studimit, ku ju kam akuzuar këtu në këtë komision, universiteteve preferenciale, një ditë para se të largoheshit nga detyra, para zgjedhjeve të përgjithshme, për të cilat duhet të mbani dhe do të jepni...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse? Se do të shkojmë në prokurori. Jo se dua unë, por ftesën ma ke bërë ti dhe do të ikim bashkë, unë me akuzat e mia dhe ti me të tuat. Do t’i shkojmë deri në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, ta dish ti! Nuk kam frikë nga deklarata jote, sepse dokumentet i kam, deklaratat i kam bërë, firmën e ke vendosur ti...

Lindita Nikolla – Zotëri, kjo është politika: mos më merr seriozisht kur flas atje, kështu më thotë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Sigurisht që do të shkoj deri në prokurori. Përdore fjalën “bashkë”, unë jam shumë i kënaqur të shoqërohem nga ty, se do të bëj figurë të mirë dhe do ta shohim pastaj se si është çështja.

Lindita Nikolla – Bëj kujdes me etikën, se nuk je shoku im.

Luçiano Boçi – Problemi është se në rastin konkret ju vazhdoni të ruani atë trendin e kërcënimit deri në fund, që, në fakt, është dobësi e argumentit tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si absolutisht? Ju sapo e thatë?! Kjo është sjellja juaj dhe unë nuk e ndryshoj dot. Në fakt, jam nisur nga kjo sjellje, për të bërë edhe deklaratën time.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nga sjellja juaj dhe nga mënyra se si ti...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk po e ndryshoj rendin e ditës. Rendi ditës është dhe do ta sqarojmë edhe atë.

(Reagime pa mikrofon.)

O Beqaj, je bërë si rrake stadium, të marrin për të bërë gërr-gërr. Pusho, more burrë, se po sqaroj! Nuk po flas me ty, por me atë. Na u bëtë të gjithë: njëri gangster, tjetri prokuror. Avash, ore, mbaje gojën dhe kujdes me qëndrimin! Rregulloji të dyja! Unë po mbaj fjalën për të paraqitur faktet për një akuzë publike.

(Reagim pa mikrofon.)

Beqaj, nuk e ke bërë ti deklaratën, rri rehat! Pse vazhdon kot, se je komplet jashtë teme?!

(Reagim pa mikrofon.)

Jo, forca politike. Nuk është jona, se akuzat i bëni ju. Unë nuk do të dëgjoj ministren kur thotë: “Ti ke shpikur.” Jo, ja, ku janë dokumentet...

Albana Vokshi – Kur nuk mban përgjegjësi ministrja për dëftesat e saj, mendoni se ku kemi arritur?!

(Reagim pa mikrofon.)

Është rendi i ditës. Pra, është arsimi parauniversitar. Sigurisht që ka.

Luçiano Boçi – Kjo çështje do të vazhdojë në prokurori. Mos mendoni se po tutemi apo po trembemi ne. Ne shqetësimin e kemi për 420 fëmijë që nuk kishin marrë dëftesat e përfundimit të vitit të shkollor që, siç tha edhe Albana, nuk ka ndodhur asnjëherë në këta 27 vjet. Shqetësimi ynë ishte legjitim, pavarësisht mimikës së ministres. Në qoftë se ka refleksion brenda dhe jashtë mimikës suaj, sigurisht që do ta miratoja, sepse momenti më i gëzueshëm i një fëmije është momenti kur merr dëftesën dhe krenohet për rezultatet që ka. Ky është momenti kulmor i vazhdimit të vitit shkollor, kënaqësi të cilën ju deri tani ua keni refuzuar. Shqetësimi ynë i paraqitur në formë

politike duhet të sjellë reagimin tuaj real, konkret dhe jo të zbrisni në nivelin e deklaratave absurde, gjëra që vazhdoni t'i bëni edhe këtu, duke mos e ndarë politikën me anën njerëzore.

Meqenëse jemi në komunikim politik, unë politikën nga ana njerëzore e ndaj. Me Beqajn njihem prej shumë vjetësh dhe zihem më shumë se me të gjithë në politikë, por nuk mundem që prej politikës të mos e përshëndes dhe të mos i flas. Pra, di ta ndaj shumë mirë anën njerëzore nga ajo politike. Në qoftë se ju nuk e ndani dot, është problemi juaj, por mos e përdorni si argument, sepse është argumenti më i dobët që mund të japë një shtetar në komunikimin e tij politik.

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla – Unë nuk e ndaj dot anën njerëzore me atë politike dhe nuk po ta jap përgjigjen që meriton.

Albana Vokshi – Fjalën e ka zoti Ulqini.

Musa Ulqini – Faleminderit, zonja kryetare!

Sot në këtë mbledhje të komisionit ne jemi thirrur për të diskutuar për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 63/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””. Kjo është çështja që kemi në rend të ditës. Kanë kaluar më shumë se 30 minuta dhe ne kemi devijuar, në shkelje të Rregullores, nga rendi i ditës. Jemi në shkelje të nenit 31, zonja kryetare, sepse në nenin 31 “Ndryshimi i rendit të ditës”, thuhet: “Kuvendi ose komisionet nuk mund të diskutojnë dhe të vendosin për çështje që nuk janë në rendin e ditës”. Çështja për të cilën ju po diskutoni prej 30 minutash, nuk është në rendin e ditës, zonja kryetare. Ju jeni të detyruar ta respektoni këtë Rregullore. Pra, jeni në shkelje të plotë të Rregullores, sepse po diskutoni për një çështje që nuk është në rend të ditës. Neni 31, pika 2, e rregullon edhe faktin se si një çështje, që nuk është në rendin e ditës, mund të futet në rendin e ditës. Kjo ishte e para dhe besoj se jam korrekt.

E dyta, ne po e zhvillojmë këtë seancë në respekt të nenit 31, për zhvillimin e seancave dëgjimore, dhe seancë dëgjimore do të thotë që ne kemi ftuar një përfaqësues të Këshillit të Ministrave për ta dëgjuar për projektin që është sjellë këtu dhe duhet ta dëgjojmë. Unë bëra një matje: për 20 minuta, që u diskutua për rendin e ditës ju, zonja kryetare, keni ndërhyre 21 herë.

Albana Vokshi – Kur e bërë këtë matje?

Musa Ulqini – Pra, është në shkelje të plotë të nenit 36, që flet për seancat dëgjimore. Kur ne themi “seancë dëgjimore”, që në titull është thënë qartë. Ne e kemi dërguar me shkrim çështjen, ose kur kemi një projektligj, ftojmë përfaqësuesin e Këshillit të Ministrave, të cilin jemi të detyruar,

pavarësisht ndryshimeve politike, ta dëgjojmë. Për 20 minuta këtu flitet për një çështje që nuk është në rendin e ditës dhe ju keni ndërhyrë 21 herë.

Albana Vokshi – Po, faleminderit!

Musa Ulqini – Jo, nuk ka nevojë për falenderimin.

Albana Vokshi – Faleminderit shumë për matjet! Të falenderoj pa fund...

Musa Ulqini – E treta, ju zonja kryetare, për 20 minuta keni përdorur fjalët: turp, mashtrim, gënjeshtër, kërcënim, pazotësi, zullum, mbulim të korrupsionit, mashtrim publik, doni t'i pëlqeni Kryeministrit, vjedhje, servilizëm, korrupsion...

Albana Vokshi – Më vjen mirë që e paske konspektuar fjalën time. Të gjitha i takojnë ministres.

Musa Ulqini – Ju, zonja kryetare, me këtë fjalor, duke shkelur katërçipërisht nenin 36, duke ndërhyrë 21 herë dhe duke mos respektuar thelbin e nenit, që ka të bëjë me seancat dëgjimore, dhe duke devijuar axhendën e komisionit, thoni: “Unë jam shumë në rregull politikisht”. Unë mendoj, zonja kryetare, se ju mund të jeni shumë në rregull politikisht, dhe unë nuk bëj komente për gjëra që nuk më takojnë, por jeni në shkelje të plotë...

Albana Vokshi – Musa, fol pak për dëftesat.

Musa Ulqini – Jeni në shkelje të plotë të kësaj Rregulloreje. Për çështjen që ju flisni, ne e ftojmë ministren, i dërgojmë kërkesë me shkrim, sipas Rregullores, dhe ministrja është e detyruar të vijë këtu e të japë shpjegime për atë çështje. Por të mblidhemi për një çështje që është e shkruar dhe ju ta devijoni, duke shkelur katërçipërisht nenin 31, pika 1, kjo nuk është procedurale, por është një situatë që na ka vënë në një pozitë të vështirë përballë publikut! Po na detyroni neve, deputetëve të maxhorancës, që ose të heshtim, ose për shkak të shkeljeve flagrante që bëni me procedurat përkatëse, të bëjmë gjëra që nuk duam t'i bëjmë.

Edhe një herë, zonja kryetare, nuk mund të shkelni, për shkak se keni mikrofonin dhe jeni kryetare, nenin që flet për organizimin e mbledhjeve të komisionit. Çështjet që nuk janë në rendin e ditës, ju nuk mund t'i...

Albana Vokshi – Të falënderoj shumë, zoti Ulqini, që keni mbajtur shënim dhe që keni konspektuar fjalën time. Dini ta bëni shumë mirë.

Musa Ulqini – Jo, nuk dua të më falënderoni, thjesht dua që të respektoni këtë Rregullore, zonja kryetare.

Albana Vokshi – Më vjen mirë që ju i konspektoni ato që them unë. Po ju sqaroj: nuk kam shkelur asnjë germë të Rregullores dhe nuk e bëj siç bëni ju, siç bëtë dje një mbledhje ilegale, sepse ju urdhëruan, për të mbuluar skandalin e fshehjes së të dhënave për truallin e Teatrit Kombëtar. Unë e mbyll mbledhjen, kur ju pa kuorum, me urdhër, bëni një mbledhje ilegale në shkelje të Kushtetutës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Në mbledhëm grupin tonë dhe nuk kishim punë fare me komisionin.

Albana Vokshi – Më fal, atëherë! Në qoftë se ishte grupi juaj, në rregull, ju kërkoj ndjesë, tërhiqem, sepse nuk mund ta bënit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Nga presioni që bëme ne, u tërhoqët. Ajo që dua t'ju sqaroj dhe mbajeni përsëri shënim, zoti Ulqini, është: nuk kam dalë nga rendi i ditës dhe po flitet për arsimin parauniversitar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ju ndërpreva, sepse ankohe mi që unë ju ndërpres. Ju më ndërprisni të gjithë mua njëzëri në çdo fjali që them. Mbaj shënime edhe këto që po them. Te qëllimi dhe objektivat që synohen të arrihen, fjalia e parë e relacionit që ka sjellë ministria është: “Projektligji që propozohet ka si qëllim rritjen e efektivitetit të zbatueshmërisë së ligjit, mbështetjen e reformave në sistemin e arsimit parauniversitar”. Paragrafi i dytë thotë: “Ndryshimet që propozohen do të mundësojnë adresimin e aspekteve që ndikojnë në cilësinë dhe efektivitetin e sistemit arsimor parauniversitar.” A po flasim ne këtu për sistemin arsimor parauniversitar? A po flasim ne këtu për rritjen e efektivitetit të sistemit arsimor parauniversitar? Nuk kemi dalë asnjë sekondë nga rendi, çdo gjë që kemi thënë këtu ka pasur të bëjë me sistemin e arsimit parauniversitar.

Unë ju ftoj të mbani përsëri shënim, se mund ta ripërsëris pyetjen që i bëra ministres: a ndihet ajo e turpëruar me mashtrimin publik që bëri para disa ditësh? As konspektet tuaja, as kërcënimet e maxhorancës që do t'i mbyllë gojën opozitës, në rastin konkret nuk vlejnë. Zoti Ulqini, zonja Ministre, duke na kërcënuar, mos mendoni se ne do të heshtim përballë problematikës shumë të madhe që ju i keni shkaktuar arsimit në përgjithësi dhe jo vetëm arsimit parauniversitar.

Lindita Nikolla – Ju, zonjë, sa më shumë flisni, aq më shumë fitoj unë.

Albana Vokshi – Duke kërcënuar, ju nuk na e mbyllni gojën për këto dëftesa, që është direkt përgjegjësia juaj! Duke kërcënuar, ju nuk ia mbyllni gojën asnjë deputeti të opozitës për të

bërë transparencë për korrupsionin në ministrinë tuaj, për paaftësinë, ndërkohë që vini këtu e të thoni se e paska sajuar opozita dhe këtë diplomë! Një ministre që nuk mban përgjegjësi për dëftesën e vet! Është e tmerrshme! Ju nuk mbani përgjegjësi për dëftesën që e keni prodhuar vetë! A e kupton?! Është jashtë çdo logjike kjo që ju bëni. Të thoni se e ka shpikur opozita edhe këtë dëftesë, është turp i turpeve! Është turp i turpeve të thoni se janë shpërndarë dëftesat, sepse mësuesit i kanë njoftuar të gjithë fëmijët me sms. Pra, ajo që mund të bënit sot, brenda etikës që ju mendoni se ju karakterizon, t'i kërkonit ndjesë dhe kaq, dhe është brenda sistemit të arsimit parauniversitar. Nuk kemi ceduar në asnjë sekondë për çështjen që po trajtohet sot, sepse kemi ardhur për të rritur efektshmërinë dhe cilësinë. Të gjithë kemi fëmijë të vegjël dhe i kemi në shkollë, dhe u bën nder edhe deputetëve të maxhorancës të flisnin këtu për këtë problem. Hajde të shohim si ta zgjidhim. A keni nevojë për komisionin tonë? Hajdeni. A keni nevojë për ndihmën tonë?! E di unë që nuk keni nevojë, sepse te pazaret nuk i futni të tjerët.

Po, Luan.

Luan Baçi – Zonja kryetare, duke marrë shkas edhe nga kolegu Ulqini, kur the se jemi jashtë rendit të ditës, sigurisht që jemi jashtë rendit të ditës, por unë mendoj se ne jemi shumë brenda rendit të ditës për arsye se çështjet e ditës dhe shqetësimet e ditës janë gjithmonë brenda rendit të ditës. Këto janë çështje që i shqetësojnë të gjithë shqiptarët. Ne të gjithë jemi prindër këtu dhe ky është vërtet një problem shqetësues e serioz, që duhet diskutuar dhe ka vend për t'u diskutuar. Mua më pëlqeu që ministria në fillim e pranoi, për hir të së vërtetës, denoncimin që ka bërë zoti Boçi në rrjetet sociale. Ishte një gabim, një faj, një problem apo një shqetësim për prindërit, pra për të gjithë. Nuk është i vetmi raste, por ka shumë raste, zonja ministre, dhe kjo është më se e vërtetë. Ky është shqetësim mbarëkombëtar, do ta quaj unë. Të mundohemi që bashkërisht të vëmë pikat mbi "i" për këtë proces shumë shqetësues dhe serioz, dhe jo të mundohemi që njëra pjesë të bëjë avokatin mbrojtës të ministres dhe pjesa tjetër të bëjë avokatin e publikut shqiptar, të prindërve. Normalisht kjo është detyra jonë: të bëjmë avokatin e prindërve, avokatin tone dhe avokatin tuaj, se edhe ju jeni prindër dhe ndoshta e keni atë shqetësim, por qëndrimi juaj politik ju bën të rrini në atë pozicion strikt dhe të mbroheni me anë të Rregullores.

Zoti Ulqini, ju keni një përvojë shumë të madhe në jetën parlamentare. Sinqerisht, unë kam respekt në këtë drejtim. Nuk duhet ta anashkalojmë kaq thjesht një problem të tillë, duke mbrojtur pa kushte ministren, qeverinë apo Kryeministrin, duke përdorur Rregulloren, kur në të vërtetë nuk e kemi shkelur Rregulloren, por jemi absolutisht brenda rendit të ditës dhe ky është një shqetësim

vërtet i madh. Kërkoj edhe prononcimin tuaj, zoti Ulqini, për këtë problem. Ashtu siç kërkoi falje ministrja...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë dëgjova sikur kërkoi falje ministrja. Mbase e dëgjova gabim, zonja Ministre, por unë ju dëgjova me vëmendje dhe ju thatë se ishte një gabim dhe kërkua ndjesë. Në qoftë se nuk ka kërkuar falje, të kërkojë falje ministrja. Falja është morale dhe kërkohet. Një shtetar, një person publik e ka në ndërgjegjen e vet, por edhe në prokurori mund të shkojë.

Këto janë arsyet pse unë mendoj se diskutimet tona në këtë komision duhet të jenë pak më realiste dhe jo ta ndara politikisht me thikë, duke bërë njëra palë avokatin mbrojtës të qeverisë, pala tjetër avokatin mbrojtës të prindërve dhe të mbarë publikut shqiptar.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Unë do t’ju bëj thirrje për diçka. Në qoftë se zoti Ulqini bëri një shpjegim se si duhet të funksionojë komisioni, ishte një shpjegim që behej mbi bazën e Rregullores. Domethënë, ne kemi një Rregullore që na udhëheq në veprimtarinë në komision. Kemi rënë dakord dhe që do të kemi këtë kalendar dhe veprimi i parë i sotmi ishte diskutimi i ndryshimeve në ligjin e arsimit parauniversitar. Natyrisht, nuk mund të themi se kjo çështje nuk na shqetëson, sepse sapo e dëgjuam edhe zonjën ministre të thoshte se kjo është një çështje që na shqetëson, për të cilën janë marrë masa si për rregullimin, edhe për denoncimin e PR-ve të ndryshme që janë bërë publike në rrjetet sociale apo në televizion. Unë besoj se duke thënë të gjitha këto gjëra, ka ardhur koha të kthehemi në normalitetin e rendit të mbledhjes së ditës sotme, të dëgjojmë shpjegimin që do të bëjë ministrja për projektligjin, pastaj të vazhdojmë diskutimin për dëftesat. Nuk po thotë njeri që dëftesa nuk është pjesë e arsimit parauniversitar, sepse ishte e para zonja ministre që e pranoi, por nuk mund ta vazhdojmë pa fund diskutimin për dëftesat. Hajde t’i kthehemi ligjit, ta mbarojmë diskutimin për ligjin që kemi para, sepse kemi pyetje për këtë ligj, kemi debate edhe për ndryshimet që po vijnë, pra t’i marrim me radhë çështjet. Nuk mund ta shmangim rendin e ditës. Radhën e kemi vendosur vetë dhe.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pavarësisht se si votuat ju, me shumicë votash apo jo, ne vendosëm kështu dhe. Unë mendoj të kthehemi në rendin e ditës dhe të vazhdojmë veprimtarinë normale të komisionit.

Luan Baçi – Më lejoni të shtoj edhe diçka tjetër, zonja kryetare. Jam plotësisht dakord për t’iu kthyer rendit të ditës, por e përsëris se rendi i ditës është ky dhe çështjet shqetësuese të ditës duhet të futen në rendin e ditës.

Ajo që dua të shtoj është fjalori kërcënues që përdoret ndaj deputetëve të opozitës. Fjalori kërcënues nuk duhet të përdoret, të paktën në komisionet parlamentare. Unë nuk shikoj të ketë fjalor fyes këtu, të paktën nga ana jonë. Drejtuesja e seancës ka ngarkesë, sepse ju flisni të gjithë në të njëjtën kohë. Ajo nuk paska të drejtë t’ju ndërpresë ju, kur të gjithë jeni në një sulm të paparë?!

Shezai Rrokaj – Mua më vjen keq që në këtë trazicion të gjatë vazhdojmë me dy të vërteta: njëra palë thotë kam unë të drejtë, pala tjetër thotë kam unë të drejtë. Në qoftë se ka ndodhur një gabim në një dëftesë, zonja Ministre, mund t’i ndodhë kujtdo, sepse ndodhin edhe gabime teknike, të cilat mund të korrigjohen. Në këtë mes nuk ka asgjë të keqe.

Nga ana tjetër, më vjen keq që në Komisionin e Edukimit kërcënojmë njëri-tjetrin me prokurori, me kacafytje. Duhet t’i lëmë vend arsyes. Arsyeja kryesore është drafti që ka ardhur, i cili ka problematika shumë të rëndësishme. Unë jam shumë i shqetësuar për disa prej tyre, duke filluar që nga mënyra e përdorimit të portalit, i cili etiketohet si “Portali për Shqipërinë”, të cilin nuk e gjej të përdorur me vend, deri edhe te disa role të Ministrisë së Arsimit, e cila bën politika, por politikat nuk i shikojmë të realizuara, siç është ajo e financimit, për shembull, në strategjinë e arsimit parauniversitar, siç është shkolla e drejtorëve, ku parazgjidhet një fondacion, me gjithë respektin që kam, por pa dhënë arsyen pse nuk ka garë. Pra, ka probleme shumë të mprehta të ndërhyrjes politike në emërimin e drejtorëve, të mundësisë së ndërhyrjes në emërimet dhe shkarkimet e drejtorëve, në emërimet dhe shkarkimet e mësuesve. Këto janë çështje që ne mund t’i bëjmë objekt të debatit dhe ia vlen të shprehemi për këto, sepse arsimi është përgjegjësi e të gjithëve.

Unë e njoh shumë mirë arsimin, sepse jam rritur në arsim. Kam dhënë kontribut edhe në arsimin parauniversitar, edhe në atë universitar dhe nuk me kanë pëlqyer edhe disa projekte që janë zbatuar në shkollat e arsimit parauniversitar, siç është ajo e disa pyetësorëve për marrëdhëniet seksuale apo edhe ndonjë projekt, me gjithë të drejtat që ata kanë, të LGBTI-së, ku ne kemi marrë një *feedback* të madh nga prindërit rreth kësaj çështjeje. Unë them të fokusohemi te këto çështje që i dhembin arsimit dhe ku mund të sjellim ide më interes për ta përmirësuar këtë draft, në mënyrë që ai të jetë sa më i përshtatshëm.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Po, Nora.

Nora Malaj – Në vijim të bisedës që bëri profesor Shezaiu, mendoj se sot na ka ardhur në komision një nga draftet më të rëndësishme që lidhet me atë që quhet: themeli bazë i sistemit të arsimit. Është një punë për të cilën duhet të diskutojmë, pasi ministria, pas disa vjetësh na sjell një draft që duhet të vlerësohet maksimalisht, duhet parë ku është e mira. Nëse ka nevojë për të bërë ndryshime, të ulemi t'i marrim nen për nen, pasi të dëgjojmë të gjithë paraqitjen që do të bëjë ministria; që të gjitha shqetësimet tona të paraqiten këtu, në mënyrë që të mos kemi problematika të tjera, të cilat, nëse nuk do t'i diskutojmë këtu, do të na bëjnë të ndihemi shumë keq. Arsimi ka jashtëzakonisht probleme, sepse është një sistem shumë i madh, që fillon nga parashkollori dhe përfundon në universitet, që kërkon kohë, investim, kreditim, nevojën për të lobuar fort për të rritur buxhetin, për të realizuar prioritetet. Unë do ta konsideroja të nevojshme që të dëgjojmë ministren në fillim, të respektojmë rendin, pastaj të gjitha pyetjet shtresuese, duke filluar nga problemet e përditshme dhe deri te problematikat e tjera që na shqetësojnë, t'i bëjmë prezente këtu, në mënyrë që të jenë të menaxhueshme dhe të monitorueshme.

Albana Vokshi – Po, Romeo, për procedurë.

Romeo Gurakuqi – Faleminderit!

Zonja Ministre, unë shpresoja se Ministria e Arsimit dhe Sporteve duhej të mbetej jashtë intrigës së lartë politike, jashtë interferencës së njerëzve, të cilët janë mësuar të korruptojnë majat e sistemit. Më vjen keq t'ju them se ju nuk keni arritur ta bëni një gjë të tillë!

Unë jam i mërzitur me ju, zonja Ministre, për shkak se nuk keni asnjë projekt të përcaktuar për nxjerrjen e arsimit shqiptar nga politizimi dhe nga kaosi në të cilin është përfshirë. Unë e di fare mirë që ju jetoni në një mjedis të rrethuar nga hiena, të cilat synojnë t'ju zënë vendin orë e sekondë, por kjo nuk do të thotë që ju të humbisni orientimin tuaj dhe të bëheni thjesht një ekzekutuese terminale e ëndrrave të shefit tuaj.

Së fundi, ndryshimet që ju keni sjellë këtu, i kam parë me shumë vëmendje. Në vend që të korrigjojnë arsimin shqiptarë, në thelbet e tyre të deformimit, të cilat ne i kemi diskutuar herë pas here në këtë komision të nderuar, në fakt, ju keni sjellë një draft, i cili nuk synon ato korrigjime për të cilat ne dhe ju kemi rënë dakord, por keni sjellë një draft, që sjell çimentimin e sistemit socialist të drejtimit të të gjithë arsimit parauniversitar shqiptar.

Me shpresën se ky komision do të jetë jashtë orientimit politik socialist dhe korrupsionit, unë dua t'ju them, zonja Ministre, se sot, në vitin e pestë të qenies suaj si ministre e Arsimit, 7 mijë maturantë shqiptarë u janë drejtuar universiteteve të vendeve të OECD-s për të ndjekur universitetin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e kam 7 mijë, por mund të jenë edhe 9 mijë, por më keq në qoftë se është kaq. Ky është një indikacion që shumë më pak nxënës dhe prindër të sistemit të shtetit tonë kanë besim në sistemin e brendshëm universitar shqiptar. Ju e dini zonja Ministre, jeni drejtuese e institucionit më të lartë të ekspertizës, aty ku është mishëruar përvoja e brezave të tërë të arsimtarëve më të spikatur dhe të themeluesve të shtetit, ju jeni pasuese e tyre. Në fakt, më vjen shumë keq t'ju them, por institucioni juaj është mbushur me fëmijë të pakualifikuar të FRESH-it, pa asnjë vit përvojë, që sillen korridoreve të institucionit tuaj.

Së treti, investimet e MAS në vend që të adresohen në ndërtimin e shkollave të reja, në vend që të drejtohen për t'u kujdesur për shkollat që kanë emergjenca natyrore, për ndërtimin e terreneve sportive, (ju jeni ministre e Arsimit dhe Sporteve) në mënyrë që të adresohen për nxënësit, që kanë nevojë edhe për aktivitetet sportive, ato janë adresuar për rikonstrukcione milionëshe të MASR-së dhe për institucionet e varësisë, të cilat, në fakt, janë thjesht ëndrra të një nate vere të Kryeministrit dhe shpurës së tij.

Së katërti, sistemi arsimor....

Albana Vokshi – Të lutem, Romeo, se është përmbajtje. Jemi për procedurë.

Romeo Gurakuqi – Të lutem, mos më ndërprit!

Albana Vokshi - Në rregull, por po më ankohen të gjithë deputetët.

Romeo Gurakuqi – Sistemi arsimor 9-vjeçar, i mesëm dhe publik, ndodhet në një amulli direktive, mësues të paguar njëlloj si më pare, edhe më pak mësues për matematikë dhe fizikë në të gjithë sistemin. Në drejtimin e sistemit të arsimit, kryesisht në Tiranë, por në të gjithë vendin, keni vendosur drejtues të njësive socialiste të Tiranës dhe të gjitha rretheve, njerëz, të cilët kanë punuar si shitës nëpër vende të ndryshëm të Ballkanit, kanë ardhur këtu dhe janë vendosur në sistem, ose në të gjithë sistemin tuaj keni vendosur njerëz, të cilët i përkasin prejardhjes nga çimentimi ish-punist i drejtimit të arsimit, fëmijë të mëkatarëve të degëve të punëve të brendshme, të ushtrisë, të komuniteteve të partisë, në një kohë kur njerëzit pa parti, të cilët nuk janë aspak të

përfaqësuar, nuk kanë asnjë vend në sistemin e drejtimit të Ministrisë Arsimit, që është institucioni më i rëndësishëm i të ardhmes së vendit.

Përpjekja juaj fillestare, e lavdërueshme do ta quaja, për ta vendosur sistemin universitar në një kuadër të përputhshëm me kuadrin legal të vendit, në vend që të shënonte një konsolidim dhe unifikim të sistemit, në fakt, shërbeu si një mjet presioni dhe diferencimi, diku edhe për joshje korruptive, dhe sot sistemi universitar operon me dy standarde, njëri i klientelës, që i gjen kanalet për t'i paguar haraçet gjithandej, dhe sistemi publik, i cili është në dekadencë të plotë.

Prej vitesh dhe prej muajsh ju kam kërkuar ribotimin e teksteve bazë të Ministrisë së Arsimit që janë botuar nga institucioni, dhe ju jo vetëm që nuk i njihni, por nuk keni dëgjuar as për të ribotuar të gjitha tekstet, të cilat i përkasin formësimit dhe edukimit atdhetar të njerëzve tanë. Zonja Ministre, në qoftë se bëjmë një balancë, midis asaj çfarë keni deklaruar në fillim para 5-vjetësh, si kupola më e lartë e arsimit shqiptar dhe e mësuesve, mësuesit nuk kanë pasur asnjë lloj rritje në sistemin e pagave të tyre, në një kohë që ju, personalisht, nuk keni bërë asnjë lloj investigimi në lidhje me këtë diferencim që ekziston në aspektin e pasurisë midis kupolës drejtuese dhe mësuesve shqiptarë, të cilat ndodhen në gjendje shumë të keqe.

Zonja Ministre, kam disa ankesa, por dua të spikas dy prej tyre, të cilat ju kanë ardhur edhe juve, por nuk keni bërë asnjë lloj korrigjimi.

Së pari, është fjala për një mësues me përvojë shumë të gjatë, Urim Halili, nga Tirana, i hequr për arsye politike. Po ashtu, javën e kaluar kam qenë në Pukë. Sistemi arsimor në këtë rreth është në një gjendje gati terrori. Një pjesë e mësuesve gjenden nën presion nga drejtimi politik. Këtu kam rastin e mësueses Fitnete Lluka në Pukë, e cila është larguar prej 3 vjetësh për arsye politike nga sistemi. Ju lutem, ta mbani shënim!

Për sa i përket korrigjimit të këtij drafti, i cili është i ndryshëm nga drafti paraprak, që e keni sjellë para 7-8 muajsh, unë e kam studiuar me shumë kujdes, por për këtë do të flas në një moment të dytë në këtë mbledhje.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Zonja kryetare, ju drejtova juve, por edhe të gjithë kolegëve, që të ndajmë momentin: do të vazhdojmë me procedurë apo do të hyjmë në përmbajtje, që të dimë dhe si të impostohemi, sepse krijohet një rreth vicioz? Të prezantojë ministrja, siç është bërë zakonisht, më pas ne këtu jemi, debatojmë, sipas pozicioneve tona.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit për ndërhyrjen!

Kishte disa pyetje për të ngritur zoti Gurakuqi, të cilat mendoj se edhe gjatë prezantimit nga ana e ministres, mund të marrin edhe ndonjë përgjigje. Kam përshtypjen që kjo ishte edhe marrja e fjalës për procedurë nga zoti Gurakuqi, i cili parashtroi një sërë çështjesh shumë të rëndësishme. Zonja Ministre, ju lutem, nëse do të më ktheni përgjigje: sa është kostoja e prodhimit të këtyre dëftesave dhe kush e mban këtë kosto, sa është dëmi ekonomik për këto, sepse janë dërguar, janë plotësuar, më pas ju i keni tërhequr me urdhër? Sa është kostoja? Na jepni koston? Sa është dëmi ekonomik për këtë pjesë, sepse nuk po flas për dëmin shoqëror shpirtëror të 420 mijë fëmijëve të tjerë. Kush e mban përgjegjësinë për këtë kosto dhe për këtë dëm në buxhet? A keni bërë ju një audit të brendshëm, një kontroll të brendshëm? E kujt është përgjegjësia për prodhimin e këtyre dëftesave? Kur do të shpërndahen dëftesat? Të lutem, sepse po më shkruajnë dhe duan një përgjigje 420 mijë fëmijë dhe të gjithë prindërit e tyre.

Lindita Nikolla - Bëjmë një marrëveshje në respekt të 420 mijë fëmijëve dhe dyfishit të prindërve të tyre, që unë të flas dhe ju të mos më ndërprisni. Patjetër që do t'ju sqaroj nga a-ja te zh-ja.

Albana Vokshi – Zonja Ministre, kur t'ju jap fjalën për projektligjin që të vazhdoni...

Lindita Nikolla - Jo, për problemin.

Albana Vokshi – Po, pra, për problemin.

Lindita Nikolla - Për atë do të kthej përgjigje nga a-ja te zh-ja, pra të gjitha përgjigjet.

Albana Vokshi – Tri përgjigje të shkurtra do të jepni.

Lindita Nikolla – Vetëm, ju lutem, respektoni 420 mijë nxënësit, mos më ndërhyini, sepse kur flet i madhi, i vogli hesht!

Albana Vokshi – Ata po respektojmë, sepse të ishte për ju, ata i kishin marrë në shtëpi 420 mijë me deklaratën tuaj, ata do t'i kishin në shtëpi dëftesat.

Lindita Nikolla - Të nderuar deputetë, ju bëj me dije se të gjitha certifikatat dhe diplomatat që lidheshin me maturantët për të studiuar jashtë shtetit janë shpërndarë dhe unë për ato kam folur. Ka pasur një gabim në rendin rendor nga 9-ta te 11-ta vetëm te dëftesat e klasës 9, të cilës, pas publikimit të deputetit në rrjetet sociale, unë i kam rikthyer përgjigjet në rrjete sociale. Është tërhequr ajo diplomë, është bërë korrigjimi...

Albana Vokshi – Sapo thatë që e kemi shpikur ne, opozita në kompjuter.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse kjo kontradiktë në atë që thoni?

Lindita Nikolla – Edhe një herë midis nocionit një fletë dhe dëftesës ka një varg, një proces të tërë. Domethënë, plotësimi dhe certifikimi nga mësuesi dhe drejtori i shkollë me firmë dhe me vulë.

Albana Vokshi - E kisha për prodhimin, sa është kostoja dhe kush e mban?

Lindita Nikolla – Kjo gjë nuk ka ndodhur.

Albana Vokshi – Sigurisht, ka ndodhur, se janë plotësuar të gjitha.

Lindita Nikolla – Nuk ka asnjë kosto.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ja *email-i* nga sekretaria e DAR-it Durrës

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka përgjegjësi, sepse është ministre. Në qoftë se nuk e di detyrën e saj, të largohet. Në qoftë se nuk kontrollon dot dëftesat, i shpërndan gabim dhe thotë se e ka fajin opozita për dëftesat...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sigurisht, kush e mban përgjegjësinë për kontrollin që janë shpërndarë?

Lindita Nikolla – Zonja Vokshi, ju keni ndonjë peshë për të larguar zonjën Topalli dhe zonja të tjera të nderuara, por nuk keni fare peshë për të larguar përfaqësuesin e kësaj qeverie nga detyra!

Albana Vokshi – Ju lutem, përgjigjuni pyetjeve, diversioni nuk ju shkon fare! Përgjigjuni pyetjeve, sepse mbani përgjegjësi!

Lindita Nikolla – Është bërë korrigjimi dhe në shkolla kanë shkuar dëftesat pa asnjë gabim. Ajo për të cilën unë kam bërë denoncimin në prokurori ka të bëjë me një fakt tjetër, që nuk thuhet që në deklaratën për shtyp deputeti akuzoi ministren e Arsimit për afera për tenderin.

Albana Vokshi – Zonja Ministre, po pse gënjeni përsëri? Ja ku e keni, janë shpërndarë dhe e keni tërhequr. Çfarë po flisni?!

Lindita Nikolla – Të nderuar deputetë,

Ju bëj me dije se tenderi për dëftesat nuk kryhet nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, por nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Brendshme, e cila ka vepruar konformë rregullave. Për këtë akuzë unë do t'i shkoj deri në fund, kam çuar kallëzim pranë prokurorisë.

Po vijoj me prezantimin:

Ne kemi ardhur këtu me një draft ndryshimesh në ligjin “Për arsimin parauniversitar” lidhur...

Albana Vokshi – Sa ishte kostoja, sepse nuk e thatë? Kur do t’i shpërndani dëftesat? Janë pyetje që po vijnë në mënyrë të vazhdueshme, ndërkohë që ne po diskutojmë këtë çështje. Po marr me dhjetëra mesazhe nga prindërit.

Lindita Nikolla – A mund të vazhdoj, sepse më duket se e sqarova?!

Albana Vokshi - Fëmijët kur do t’i marrin dëftesat? A jeni ju përgjegjëse për këtë?

Lindita Nikolla – Dëftesat po vijojnë të shpërndahen në shkolla.

Albana Vokshi – “Qytetari dixhital”, prindërit te ne kanë shpresë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju i keni mashtruar, prandaj drejtohen vetëm te ne. Atë e keni kuptuar, apo nuk e keni kuptuar, tashmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sepse me mungesë kompetence, me korrupsion, me vjedhje, nuk ka më.

Ismet Beqiraj – Ti je shpëtimtarja e 420 mijë prindërve dhe fëmijëve!

Albana Vokshi - Shpëtimtare nuk jam, por zërin do ta ngremë të gjithë ne.

Ismet Beqiraj – Shyqyr! Në një shkollë janë vajza jote, edhe vajza ime.

Albana Vokshi - Vetëm të na thotë kur do të shpërndahen dëftesat?

Zoti Beqaj, jeni ju i interesuar që personat, votuesit tuaj që kanë fëmijët të marrin dëftesat? Unë mendoj se po.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kur?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sot. Domethënë, opozita e paska bërë një punë të mirë.

Lindita Nikolla – Që dje, që pardje.

Albana Vokshi - Opozita e paska bërë një punë të mirë, ju ka detyruar juve të lini pushimet dhe të ktheheni që të dorëzoni dëftesat. Ne këtë kërkuam. Atëherë, këtu pranojeni. Ky është gabimi. Kush mban përgjegjësi për këtë? Të tregojë: pse nuk janë shpërndarë, pse u vonua tenderi, kush mban përgjegjësi për këtë? Atëherë, këtu hyn prokuroria. Realisht, prokuroria duhet ta hetojë këtë çështje. Nëse ka prokurori, ta hetojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja ku janë shpifjet, sepse tha se e kemi sajuar neve. Opozita po e bëka detyrën e saj. Opozita është brenda funksionit të saj, derisa e detyroi ministrinë të fillojë të shpërndajë dëftesat.

Lindita Nikolla - Faleminderit!

Sigurisht, kanë qenë disa ndryshime të diktuar nga zhvillimet dhe nga e gjithë reforma që ne kemi ndërmarrë në arsimin parauniversitar, po ashtu edhe në arsimin e lartë, shtuar këtu referuar ligjin për ndarjen e re territoriale. Ky projektligj është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit në dhjetor të vitit 2017. Është ngritur një grup pune, i cili ka pasur detyrimin dhe ka ndjekur, përmes një kalendari rigoroz, të gjithë konsultimin publik, duke filluar nga institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, organizatave partnere, UNICEF, Save the Children, World Vision, Soros e të tjerë, si dhe partnerëve social, Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shoqatës Kombëtare të Prindërve.

Gjithashtu, për të ardhur deri këtu, projektligji ka ndjekur edhe procesin e tij normal të konsultimit dhe të marrjes së gjithë vërejtjeve nga ministrinë e linjës, për të cilat ju bëj me dije se është ndjekur një proces shumë serioz, edhe diskutimi nen për nen nga grupi i punës, kryesisht me organizatat partnere dhe partnerët socialë, duke reflektuar shumë prej kërkesave që këta partnerë të rëndësishëm kanë pasur në funksion të përmirësimit të ligjit.

Unë po i marr me radhë të gjitha çështjet se ku konsistojnë ndryshimet në këtë projektligj dhe çfarë sjellin ato, dhe pse janë risi në vlerësim të cilësisë së re në arsimin parauniversitar. Besoj se biem dakord, edhe për t'i dhënë përgjigje profesorit, i cili tha se ende ne kemi në krye të shkollave drejtues politik. Po, është e vërtetë! E kam thënë dhe e them sa herë që kam mundësi, ende nuk i jemi larguar kulturës së vjetër, të kapjes së drejtimit të shkollës nga politika. Pikërisht, ky orientim i ri, përmes një instrumenti të ri, që do të jetë procesi i certifikimit, pasi kalohet nga shkolla e drejtorëve, bën të mundur jo vetëm zero ndërhyrjen e politikës në arsim, por edhe...

(Diskutime pa mikrofon.)

Zero është një numër interesant, nuk është budallallëk!

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Kush e vendos këtë ikën apo rri? Me dëshirën tuaj, ne nuk duhet të ishim fare këtu. Po e dëgjojmë me shumë vëmendje, por t'i heq pak...

(Diskutime pa mikrofon.)

Sa herë ndërhyri ju?

Në rregull, duhet të marrë leje, nuk foli për procedure, vetëm i bëri një koment. Zero politikë. Të thuash zero politikë në këtë projektligj, që është krejtësisht i politizuar, është turp i madh!

(Diskutime pa mikrofon.)

Në rregull!

Ajo kërkoi fjalën për procedurë, unë nuk e pashë dhe ia kalova fjalën ministres. Duhet të kishte folur për procedurë.

Lindita Nikolla – Besoj se për të rritur cilësinë në arsim, në sistemin e administrimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore, kemi ende shumë rrugë të gjatë, pikërisht për të përmirësuar burimet njerëzore, ata drejtues apo drejtuese, që do të vëmë në krye të shkollave, duke u dhënë mundësi kualifikimit të tyre përmes një shkolle, që ne e vendosim dhe në ligj, shkollës së drejtorëve, e cila ka përgjegjësinë të bëjë trajnimin dhe më pas certifikimin e të gjithë atyre që aspirojnë për të qenë drejtues të shkollave. Pra, shkolla e drejtorëve do të jetë një person juridik, që ka për qëllim zhvillimin profesional të drejtuesve dhe të kandidatit për drejtues të institucionit arsimor parauniversitar publik ose privat, administrimin e procesit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për pajisjen me certifikatë për drejtimin e institucioneve arsimore parauniversitare dhe të trajnimit në vazhdim të drejtuesve të shkollave. Shkolla e drejtorëve gëzon një pavarësi drejtuese administrative, financiare dhe teknike.

Së dyti, organizimi dhe funksionimi i shkollës së drejtorëve, si dhe mënyra e trajnimeve dhe e certifikimit të drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për Arsimin.

Këtu dua të falënderoj Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, i cili ka qenë thelbi dhe një partner shumë i rëndësishëm për të mundësuar këtë projekt, i cili unë besoj, por edhe të gjithë diskutimet që ne kemi pasur me partnerët, që do të sjellë një histori të re të menaxhimit dhe të miradministrimit të sistemit arsimor në nivel drejtuesish shkolle. Patjetër janë autoritete, që kanë mundësuar modelet më të mira, me të cilat bota operon, standardet më të mira dhe të Bashkimit Europian për të mësuar module trajnuese dhe certifikimi për drejtuesit e shkollave. Sigurisht, ajo që duhet përmendur, cilësohet edhe në ligj, është fakti që shkolla e drejtorëve është aty edhe për t'iu përgjigjur nevojave për kualifikim në vazhdim, pasi drejtuesit e certifikuar do të marrin detyrën për të qenë në krye të shkollave.

Gjithashtu, më lejoni t'ju informoj që Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit ka pasur një projekt pilot që lidhej me shkollën e drejtorëve, duke trajnuar rreth 213 drejtues nga disa drejtori arsimor rajonale, me disa module, 324 orë trajnimi, gjithsej 18 kredite, drejtues si lider pedagogjik dhe menaxheri i personelit mësimor, strukturat organizative të shkollës dhe menaxhimi i kurrikulës, menaxhimi i burimeve materiale dhe financiare të shkollës, planifikimi për zhvillimin e institucioneve arsimor, etika, komunikimi dhe bashkëpunimi me komunitetin, sistemi i vlerësimit, performancës së drejtorit të shkollës. Pra, janë module thelbësore, për të cilat ne kemi konstatuar që e gjithë masa që sot apo qoftë edhe ata që aspirojnë për të qenë në krye të shkollave, kanë nevojë për një kualifikim shumë më cilësor dhe të orientuar nga standardet më të mira ndërkombëtare.

Vijojmë me çështjen tjetër, që riadreson ky ndryshim që ne kërkojmë të bëjmë në ligj, është portali “Mësues për Shqipërinë”. Ka qenë një procedurë që bazohej mbi një udhëzim ministri. Ne duam ta ngremë në nivel më të lartë, ta çojmë në ligj, në mënyrë që kjo risi e futur në sistemin tonë arsimor, nuk ka qenë e paligjshme, ka qenë e orientuar me udhëzim ministri, të ngrihet në nivel ligji për t'i dhënë edhe më shumë forcë një instrumenti që ka çuar pranë shkollave mësuesit më cilësorë. Më lejoni t'ju them që portali “Mësues për Shqipërinë” është një platformë *online*, që mundëson rankimin, transparencën, bazuar në meritë preferencë të gjithë punëkërkuessve. Në bazë të rankimit që kanë në portalin “Mësues për Shqipërinë”, sigurisht orientohet dhe punësimi i tyre. Portali “Mësues për Shqipërinë”, pra kjo platformë do të ketë edhe dy informacione të tjera shumë të rëndësishme, një që lidhet me transparencën e vendeve të lira, që krijohen në sistemin arsimor dhe, së dyti, ka një ndërlidhje me platformën tjetër të kualifikimit. Pra, çdo punëkërkuess, që rezulton i rankuar ulët në sistemin e vlerësimit, mund t'i drejtohet portalit tjetër për të marrë trajnimet e duhura, në mënyrë që të përparojë në renditjen e tij.

Lejomëni t'ju them se gjatë testimit të kandidatëve që u krye këtë vit, risi ishte fakti që testimi nuk bëhej më në letër, por bëhej online, duke i marrë përgjigjet në kohë reale pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore për vlerësimin dhe përgjigjet e dhëna në testin e vlerësimit.

Nga viti 2013 deri në vitin 2017 kanë aplikuar në portal 13800 mësues, nga të cilët janë punësuar, sipas meritës dhe preferencës së tyre, 4330 të tillë. Në vitin 2018, pra në vitin që ne jemi, kanë aplikuar në portalin “Mësues për Shqipërinë” rreth 5000 kandidatë, sepse ka kandidatë dhe portali u njeh të drejtën edhe të rifuten, në mënyrë që të kenë mundësi të përparojnë në renditjen e tyre.

Për sa i përket pikës tjetër, që lidhet me riorganizimin dhe funksionet kryesore të ministrisë dhe institucioneve të varësisë, është...

(Debat në sallë.)

Albana Vokshi – Edhe për këtë e ka fajin opozita, se je ulur ti me kurriz nga ministrja?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni!

Lindita Nikolla – Dilema dhe kënaqësia e njeriut që i di të gjitha, në fakt, është për t'u admiruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë po vazhdoj.

(Deputeti Boçi flet pa mikrofon.)

Siç po thosha, riorganizimi dhe funksionet kryesore të ministrisë dhe të institucioneve të varësisë kanë të bëjnë pikërisht me vizionin qeverisës për të ndarë fushat e përgjegjësisë, duke i lënë detyrë Ministrisë së Arsimit edhe vënien e theksit kryesisht në rolin politikëbërës...

Albana Vokshi – “Qytetari dixhital” po shkruan tani dhe po denoncon...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – ...të institucioneve të tjera të varësisë.

Albana Vokshi – ... të gjitha emërimet politike, një nga një.

Lindita Nikolla – Sigurisht, edhe ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet agjencive që kanë për detyrë të ofrojnë shërbimin dhe agjencive që kanë për detyrë të monitorojnë dhe të sigurojnë cilësinë, pra të zbatojnë politikat dhe programet e hartuara nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E rëndësishme është të theksojmë, po ashtu, se ndryshimi që propozojmë në ligjin “Për arsimin parauniversitar” rikthen një moment shumë të rëndësishëm, që lidhet me monitorimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, duke e rivitalizuar procesin e inspektimit dhe vlerësimit të standardeve në qendër, por, në mënyrë kapilare, duke shkuar deri në shkollë, sepse ne do të kemi edhe inspektorët që do të organizohen në bazë të njësive arsimore vendore. Riorganizimi i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar ishte një detyrim që lindi edhe me ndryshimet në ligjin për ndarjen e re territoriale. Po ashtu, i kemi dhënë përparësi edhe faktit që në këtë këshill të kemi një përfaqësues të ministrit

të Diasporës, në mënyrë që të ketë një fokus edhe më të madh, që lidhet me arsimimin në gjuhën dhe kulturën shqiptare për fëmijët e shqiptarëve jashtë atdheut. Sigurisht, është shtuar edhe një përfaqësues i Këshillit Kombëtar të Prindërve, sepse kemi edhe një instrument të ri, edhe një institucion të ri, që është Këshilli Kombëtar i Prindërve (neni 7 i këtij projektligji), i cili do të shërbejë si një interlokutor shumë i mirë ndërmjet komunitetit të prindërve dhe Ministrisë së Arsimit dhe, po ashtu, do të luajë një rol kyç për të monitoruar dhe për të ndarë me politikëbërjen të gjitha interesat që prindërit kanë lidhur me cilësinë në sistemin tonë arsimor.

Risi tjetër është edhe fakti se ky projektligj i çel udhën asaj, që, në fakt, ka qenë një kërkesë e vijueshme nga shkollat dhe drejtuesit e tyre për t'u dhënë shkollave një mundësi, një liri financiare nëpërmjet krijimit të bazës së tyre në Thesar për të gjitha të ardhurat që institucionet arsimore do të kenë nga prindër apo donacione të ndryshme, nga organizata apo qoftë edhe nga biznesi. Këto donacione që i dhurohen shkollës, institucionit arsimor, arkëtohen dhe përdoren në mënyrën 100%...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...për nevojat e institucionit arsimor.

Albana Vokshi – A mund ta përmbledhni, ju lutem, dhe të fokusoheni vetëm te çështjet kryesore?...

Lindita Nikolla – Të ardhurat e papërdorura nuk kalojnë në buxhetin e shtetit, por i mbeten institucionit arsimor.

Albana Vokshi – ...sepse edhe Iliri u mërzi shumë?

Lindita Nikolla – Është shumë e rëndësishme të themi se ky është një nga momentet e rëndësishme...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...të superkërkuara nga kolektivat e mësuesve, drejtuesit e shkollave, por po ashtu edhe nga prindërit.

Kemi bërë një ndërhyrje në ligj për sa i përket ndërprerjes dhe revokimit të licencave në shkollat private. Ligji i mëparshëm bënte të mundur vetëm ndërhyrjen në fund të procesit shkollor, ndërkohë ne kërkojmë që kjo të jetë menjëherë e zbatueshme, sepse konstatojmë që edhe pse verifikojmë shkelje të rënda të ligjit, duhet të presim deri në përfundim të shkollës për ta hequr licencën, për të ndërprerë veprimtarinë e institucionit arsimor. Ndërsa në rastet kur institucioni arsimor vendos vetë që të ndërpresë veprimtarinë e tij, ajo ndërpritet në kohë reale.

Një tjetër risi e këtij projektligji dhe propozimeve të sjella ka të bëjë me vlerësimin e nxënësve dhe vlerësimin e arritjeve. Futet një moment, siç është vlerësimi kombëtar, pas përfundimit të arsimit të ciklit të ulët fillor në klasën e pestë për të pasur një matje, në mënyrë që ne të shikojmë se sa dhe si është cilësia e arritjeve të nxënësve pasi përfundojnë një cikël shkollimi. Kjo mungonte, sepse e kishim vetëm në klasën e nëntë dhe në maturë. Besoj se kuadri bëhet edhe më i plotë me futjen e testimit kombëtar edhe në klasën e pestë, që do t'u mundësojë shkollës, prindit, nxënësit, ministrisë dhe shoqërisë një adresim më të mirë të politikave që lidhen me cilësinë që në moshë të hershme dhe evidentimin e problematikave që në fillim, pa kaluar më pas në stadet e tjera të arsimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për sa u përket emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucioneve të arsimit parashkollor, edhe ky është një moment që duhet riadresuar, sepse me ndarjen e re territoriale dhe me ligjin e ri, duke i kaluar më shumë autoritet pushtetit vendor në kuadër të decentralizimit, ka mbetur i parregulluar se kush emëron drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore. Ligji adreson se ky është kryetari i bashkisë, sigurisht duke ndjekur procedurat dhe kriteret.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se kur lidhet me emërimin e personelit në kopshte apo në çerdhe, por kryesisht në kopshte, duhet t'i referohemi standardit të ri, që është niveli mësues për arsimin parashkollor, sigurisht duke iu referuar renditjes që këta mësues marrin në portalin e klasifikimit.

Po ashtu, ligji adreson edhe një tjetër moment të rëndësishëm, që ka të bëjë me përcaktimet e nenit 83 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë”, nen i cili u dedikohet programeve të studimit në fushën e mësuesisë. Ndryshimi i propozuar synon të qartësojë nivelin arsimor të kandidatëve për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesve për arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë. Ndryshimi konsiston në faktin se në ligjin aktual emërimi i punonjësve në arsimin parashkollor parashikon diplomë “Bachelor”, pa specifikuar formimin universitar në këtë cikël shkollor.

Me përjashtimin në ligj të diplomës së ciklit të parë “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor, sigurohet instrumenti i nevojshëm normativ për të siguruar cilësi edhe në edukim që në moshën e hershme.

Po ashtu, ndryshimet në pikat 2 dhe 3 për formimin e mësuesve në arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë janë parashikuar për shkak të përshtatjes me nenin 83 të ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Këto ndryshime, gjithashtu, do të mundësojnë marrjen në konsideratë dhe përfshirjen e të gjitha burimeve njerëzore, të cilët nuk kanë titullin “Mësues”, por disponojnë diploma universitare të njëjta ose të përafërta në fushat, lëndët që zbatohen në kurrikulat shkollore të sistemit parauniversitar.

Albana Vokshi – Duke ju kërkuar ndjesë, a mund t’i përmbledhni, se ne e kemi lexuar relacionin me shumë kujdes?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi nevojë t’u lëmë hapësirë pyetjeve që kemi për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kemi lexuar relacionin me shumë kujdes, madje edhe e kemi konspektuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Brenda mundësive...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I ka konsultuar, pra! Ajo tha se ka kryer të gjitha procedurat...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani, unë kam kërkesë nga disa deputetë, të cilët kërkojnë një përmbledhje.

A është e mundur, zonja Ministre, t’i përmbledhni dhe ne të kemi mundësi të bëjmë pyetje dhe të diskutojmë?...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Musa Ulqini – ...një fjali.

Albana Vokshi – I kërkoja ndjesë për ndërprerjen, sepse deputetët po kërkonin...

Musa Ulqini – Një sekondë!

Në momentin që flasim, jemi në rastin e nenit 47 “E drejta e fjalës për anëtarët e Këshillit të Ministrave”: “Për paraqitjen e projektligjeve Kryeministri dhe ministri kundërfirmues...”, që në këtë rast është zonja Lindita “...kanë të drejtë të flasin pa kufizim kohor”.

Ju lutem, respektojeni këtë kërkesë të Rregullores!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Zoti Ulqini, e dëgjove çfarë i thashë? Duke i kërkuar ndjesë për ndërprerjen, e pyeta: “A është e mundur t’i përmbliidhni çështjet, në mënyrë që të kemi më shumë kohë për pyetjet dhe për të marrë informacion?” Kaq. Na lexoni Rregulloren kot!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Atëherë...

(Kryetarja e komisionit flet pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nëse është e mundur ta përmbliidhni, sepse as deputetët tuaj të komisionit nuk po ju dëgjojnë më.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Kandidatët për mësues...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Duhet ta kishe bërë shënimin përpara.

Lindita Nikolla – ...të cilët nuk kanë titullin “Mësues”...

Albana Vokshi – Ne e kemi bërë konspektin në shtëpi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këto janë, shihini!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – ...por kanë formimin universitar në fushat dhe lëndët e përafërta me kurrikulën e sistemit arsimor, do të mbështeten në zhvillimin e tyre profesional me programe të vazhduara formimi në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këto programe do të ofrohen nga IAL-të, pra nga institucionet tona të arsimit të lartë, duke u dhënë mundësi edhe këtyre të diplomuarve për të qenë pjesë e sistemit arsimor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – I thashë ta përmbledhë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Parauniversitar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani, ta kishe lexuar, o profesor!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vijojmë.

Po ashtu, këto dispozita kalimtare, të përcaktuara në nenin 22, normojnë të gjithë kohëzgjatjen e periudhës kalimtare deri në certifikimin e drejtorit të institucionit arsimor parauniversitar, drejtorit të institucionit arsimor parashkollor dhe nëndrejtorëve të këtyre institucioneve. Ky rregullim bëhet për të motivuar personelin mësimdhënës që ka përfunduar studimet universitare, po ashtu edhe nga ish-institutet e larta pedagogjike, duke i harmonizuar me ndryshimet në këtë ligj.

Fokus i veçantë u jepet edhe nxënësve me aftësi të kufizuar, që ka qenë një kërkesë dhe një debat i diskutuar edhe me partnerët tanë. Neni 28 është ndërtuar së bashku me ata dhe e riformatuar, duke e ngritur cilësisht edhe këtë shërbim në sistemin tonë arsimor, për të realizuar gjithëpërfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuar në sistemin tonë arsimor.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja Ministre, për të gjithë shtjellimin që u bëtë ndryshimeve të këtij projektligji!

Dua t’ju lexoj një mesazh që sapo më erdhi, i cili është për ju: “Po e ndjek me shumë vëmendje televizorin. Të lutem, lexoja sms-në ministres Nikolla: çfarë borxhi i kam që të lë pushimet e verës dhe të kthehem, pasi jam bashkëshorte e një arsimtari?”!

Zonja në fjalë është njoftuar dje me sms, me tekst, se duhet të paraqitet në shkollë për të tërhequr dëftesat dhe ajo pyet: “Çfarë borxhi i kam unë zonjës Nikolla dhe kush m’i paguan mua këto shpenzime? Dua një përgjigje nga zonja ministre!”. Pra, jo vetëm keni shkaktuar dëm ekonomik me dëftesat e lirimit, që sapo jua treguam...

Lindita Nikolla – Zot i madh!

Albana Vokshi – ...por ju po shkaktoni kosto shtesë, stres tek të gjitha familjet e të gjithë arsimtarëve, të cilët po i detyroni të lënë pushimet dhe të kthehen në detyrë, sepse ju, në mungesë të kompetencës dhe përgjegjshmërisë, nuk i keni prodhuar në kohë dëftesat. Ja ku është rasti. Mësuesi dixhital po e dërgon këtë për t’jua bërë pyetjen juve dhe që ju t’i ktheni një përgjigje. Kush ua paguan pushimet këtyre arsimtarëve që po i detyroni të kthehen nga andej ku kanë shkuar bashkë me familjet e tyre?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lindita Nikolla – Atëherë, nëse ju më thoni se për cilën shkollë bëhet fjalë, patjetër...

Albana Vokshi – Të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – A ka mundësi, zotëri?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Janë të gjitha shkollat që e kanë marrë si porosi.

Lindita Nikolla – Mund të ma thoni kush është zotëria të cilit i kam borxh unë, që të shkoj t'ia kthej borxhin te shkolla?! Ndërkohë...

Albana Vokshi – 34 mijë mësuesve do t'ua ktheni borxhin!

Lindita Nikolla – Zonjë, ju lutem!

Ndërkohë që mësuesit e dinë fare mirë se çfarë po bëjnë dhe, sigurisht, nuk kanë asnjë lloj shqetësimi, unë nuk jam nga ata njerëz që i drejtohem të shkuarës. Është një përvojë që ne e kemi bërë gjithmonë dhe raste të tilla me vonesa të daljes së dëftesave ka pasur edhe herë të tjera. Sigurisht, mësuesit do të përfitojnë nga leja e tyre këto ditë, që përtej lejes, po i zbatojnë në krye të detyrës. Ndaj mësuesi është mësues...

Albana Vokshi – Si përfitojnë mësuesit nga leja?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, e ka shkelur kontratën e sapofirmosur!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kontrata ka një numër të caktuar ditësh pushimi për mësuesit.

Lindita Nikolla – Edhe një herë...

Albana Vokshi – Në çelje të kontratës po i kthen dy herë mësuesit.

Lindita Nikolla – Mësuesit, ndaj janë mësues, sepse janë në...

Albana Vokshi – Ata 34 mijë mësues të shkojnë te ministrja dhe t'ua paguajë ministrja të gjitha pushimet, se kështu tha, apo jo?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kontrata kolektive.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si? I ka zgjidhur Kodi i Punës pagesat?!

Po pushimet kush ua paguan atyre?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pushimet, pra, Kodi i Punës ua paguan?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe pushimet e tyre? Çfarë flet tani! Ju nuk po dini çfarë të flisni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po prishni çdo pushim, çdo rehati! Po u shkaktoni kosto financiare dhe në vend që t'u thoni: "më falni!", u thoni se këtë aspekt e ka rregulluar Kodi i Punës!

Lindita Nikolla – Zonjë, ju lutem!

Mësuesit janë qenie shumë dinjitoze...

Albana Vokshi – Janë, pra, janë dhe prandaj se janë qenie dinjitoze, po të çojnë mesazhe!

Lindita Nikolla – Janë njerëzit më të nderuar!

Albana Vokshi – Se janë dinjitozë po rrinë para televizorit duke ju ndjekur!

Lindita Nikolla – Njerëzit...

Albana Vokshi – Pyetja ishte për ju.

Lindita Nikolla – Mësuesit janë njerëzit më të nderuar të kësaj shoqërie, që dinë dhe kuptojnë. Madje po ju bëj me dije, po ashtu, se në kohën kur ata duhej të plotësonin dëftesat, por që për shkak të vonesës dhe të këtij korrigjimi, që unë e përmenda, dëftesat nuk ishin në shkollë, mësuesit kanë qëndruar në shtëpi. Pra, kanë bërë leje, kur duhej të ishin në punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, po i zëvendësojnë ato ditë, me këto ditë me plotësimin e dëftesave.

Albana Vokshi – Kjo nuk është fare e vërtetë!

Lindita Nikolla – Boll më me këtë histori, sepse janë 37 mijë mësues...

Albana Vokshi – Këtë punë kemi ne, po vazhdojnë mesazhet! Ndërkohë, ti boll me këtë histori!

Lindita Nikolla – Me ligjin e tyre është shumë më e rëndësishme.

Albana Vokshi – Duhet t'u përgjigjeni të gjithë mësuesve që janë, sikurse juve edhe e cilësuat, ndër qytetarët më dinjitozë dhe as duhen ofenduar, as duhen fyer, as duhen nëpërkëmbur, as përçmuar, kështu sikurse ju po bëni me ta!

Lindita Nikolla – Mos i fyej, pra, të lutem, mos i fyej mësuesit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Sa mirë që jemi live dhe po na ndjekin, zonja mësuese, se ju mësuese...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sepse duhej të ishit sjellë shumë herë më mirë...

Lindita Nikolla – Si ty!

Albana Vokshi – ...pa i nëpërkëmbur, pa i fyer mësuesit, atë që ju, sa vite jeni ministre, e keni bërë në mënyrë sistematike!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk jua kam dhënë fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e ndërpreva!

Ia kam dhënë fjalën Izmirës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Çfarë nuk duhet të bëj?

Albana Vokshi – Ju lutem, se nuk jua kam dhënë fjalën!

Ju dëgjuam me shumë qetësi! Ju nuk jeni e qetë, kjo duket...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra, fjalën e ka Izmira për dy pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani, mësuesi dixhital e donte një përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të shkojë t’i marrë lekët te ministrja, se atë ka...!

Izmira Ulqinaku – Zonja kryetare...

Albana Vokshi – Pushohet nga puna ai pastaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po t’ju tregoj emrat e mësuesve dixhitalë, sepse me këtë projektligj që keni sjellë, ju i vini dërmën njëherë e mirë arsimit parauniversitar! Po e politizoni njëherë e mirë! Po e shkatërroi njëherë e mirë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kështu që, atë dixhitalin...

Ilir Beqaj – Prej jush dëgjuam një lajm shumë të mirë sot...

Albana Vokshi – Kur ta merrni fjalën, thojeni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ilir Beqaj – Për pesë vjet ua rritëm nivelin e jetesës dhe shqyr sot janë të gjithë me pushime.

Albana Vokshi – Jo, ore!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse ju i nxorët mësuesit në selamet, se nuk kishin parë pushime me sy më përpara?! Hajde-hajde, çfarë ideje keni ju për mësuesit! Çfarë turpi!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zonja Ulqinaku.

Izmira Ulqinaku – Faleminderit, zonja kryetare e komisionit, që më dhatë fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – E tha ministrja. Mos më vër në gojë gjëra që i tha ministrja. Ajo tha: “të vijë se do t’ia paguaj unë!”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

T’ua paguajë që të 34 mijë mësuesve!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, Izmira.

Izmira Ulqinaku – Faleminderit, zonja kryetare e komisionit, që më dhatë fjalën!

Unë kam dy pyetje dhe do të flas shumë shkurt, në ndryshim nga zonja ministre, që mori gjithë këtë kohë, foli e foli pa thënë asgjë, aq sa nuk morën vesh gjë as prindërit, as fëmijët, as ne këtu!

E para, zonja Ministre, pse jeni kaq e papërgjegjshme? Si vini në një komision arsimit dhe jeni kaq e papërgjegjshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Nga e kuptove ti që është e papërgjegjshme?

(Debat në sallë.)

Izmira Ulqinaku – Do ta sqaroj!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është e papërgjegjshme!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pyetje e kam.

(Deputeti Ylli ndërhyrje pa mikrofon.)

Janë 420 mijë fëmijë që janë ofenduar nga zonja ministre!

Janë dyfishi i prindërve që janë ofenduar nga zonja ministre!

Është mundi...

(Diskutime në sallë.)

Albana Vokshi – Më falni!

A ka mundësi pak respekt, ju lutem?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbani pak qetësi dhe dëgjoni pyetjet!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, se po flasim për mësuesit që vazhdojnë të na dërgojnë mesazhe!

Vazhdoni, zonja Ulqinaku!

Izmira Ulqinaku – Është mundi dhe djersa e 420 mijë fëmijëve, i dyfishit të prindërve dhe 34 mijë mësuesve që ju i keni ofenduar! Ju ua keni hedhur të gjithë punën poshtë!

Si ka mundësi që vini këtu e mbani një referat të shkruar nga Partia Socialiste dhe nuk ka mundësi të shkruhet një referat i tillë nga një ministre e përgjegjshme? Kjo ishte pyetja ime e parë.

Pyetja ime e dytë është kjo: pse nuk shpërndahen dëftesat e sakta? E morëm vesh se janë shpërndarë dëftesat e gabuara. Tani, pse nuk shpërndahen ato të saktat? Pse fëmijët nuk i marrin dëftesat, pasi duhet të shpërngulen nga kjo shkollë në një tjetër? Pse nuk shpërngulen dot?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse nuk dalin jashtë shtetit të shkollohen? Sepse nuk i kanë dëftesat të sakta! Ku do të shkojnë me dëftesat e gabuara? Kush ua pranon?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani, ne e morëm vesh se fëmijët tuaj janë në shkolla shumë të mira jashtë shtetit, ua ka bërë Zoti risk, por kështu nuk janë të gjithë fëmijët shqiptarë!

(Deputetja Ekonomi flet pa mikrofon.)

Nuk po flas tani...!

Albana Vokshi – Milva, të lutem!

Izmira Ulqinaku – Kemi fëmijë në zona rurale që nuk kanë mundësi të shkojnë në drejtoritë arsimore të marrin dëftesat e sakta, por i marrim nga dy-tri herë të gabuara.

A e dini ju që, përveçse është kosto e qeverisë, kostoja është edhe e familjarëve; kostoja është edhe e prindërve që marrin urbanin, marrin furgonin? Ju nuk i llogarisni këto gjëra!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prandaj, pyetja e parë është: pse jeni kaq e papërgjegjshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po e sqaron, pra, po e sqaron!

Izmira Ulqinaku – Ndërsa pyetja e dytë është: pse nuk shpërndahen dëftesat e sakta? Kaq kisha.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Po, zonja Mehmetaj.

Kejdi Mehmetaj – Faleminderit!

(Diskutime në sallë.)

Ta ketë mendjen zonja ministre, se unë për të i kam pyetjet!

Albana Vokshi – Zonja Ministre, a ka mundësi, ju lutem?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e di, a i mbajtët shënim dy pyetjet e zonjës Ulqinaku?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

Mund t’i përsërisim, në qoftë se nuk i keni dëgjuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zonja Mehmetaj.

Kejdi Mehmetaj – Faleminderit!

Në radhë të parë, që të jem shumë e sinqertë, më vjen ndonjëherë keq edhe për nivelin që, si deputetë, tregojmë në këtë komision, aq sa, dhe këtë e kam të sinqertë edhe për kolegët e maxhorancës, lëreni ndonjëherë ministren të flasë vetë, se, më besoni, ndoshta e mbron veten më mirë sesa e mbron ju, se edhe kur ju bëni ndonjë tentativë, bëheni në sy të publikut, sinqerisht e them, edhe të padëgjueshëm, edhe të pashikueshëm. Megjithatë, unë po drejtoj disa pyetje dhe disa shqetësime lidhur me projektligjin që është depozituar, njëkohësisht edhe për disa probleme nëpër të cilat po kalon sistemi parauniversitar.

Së pari, kur u prezantua projektligji, u fol për portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe, kur njëri nga kolegët e tha, me të drejtë, se është i paligjshëm për vitet në të cilat është zbatuar, ministrja nxitoi ta kundërshtonte. Por unë dua të them një fakt që vërteton se portali ka qenë i paligjshëm në 4 vjetët e përdorimit të tij. Në një kontroll publik të KLSH-së para disa ditëve, në një tryezë ku diskutohej për çështjet e arsimit, përfaqësuesi i KLSH-së ka thënë se në mënyrë të vazhduar në drejtim të ministrisë dhe në të njëjtën kohë, edhe të zonjës ministre si drejtuese e asaj ministrie,

janë dërguar kontrolle të KLSH-së, ku thuhet qartë ndër të tjera, se portali “Mësues për Shqipërinë” është i paligjshëm.

Përveçse nuk ka pasur kthim përgjigje nga ana juaj, nuk ka pasur as reflektim.

Ja ku po vërtetohet sot se për disa vite me radhë mësuesit janë hequr dhe janë vënë nga puna në mënyrë të paligjshme, duke përdorur një portal, i cili sot po tenton të legjitimohet, por për mënyrën e ndërtimit të tij sigurisht, nuk e meriton legjitimimin.

Zonja Ministre, cila është përgjegjësia juaj lidhur me paligjshmërinë e këtij portali, që është paraqitur edhe në raportet e KLSH-së? Nëse ju nuk i mbani mend, unë kam disa prej tyre me vete dhe mund t’juja vë në dispozicion.

Nga ana tjetër, ne si deputetë, jo vetëm tani, por edhe më parë kemi marrë shqetësime të vazhdueshme nga ata që kanë aplikuar në portal dhe na kanë treguar abuzimin e vazhdueshëm.

Rasti i mësuesve që dalin të parët apo të dytët në portal, të cilët nuk punësohen edhe 2 vjet pasi kanë aplikuar në portal, por nga ana tjetër, ata që kanë dalë të gjashtë apo të shtatët për shkak të njohjeve me partinë, me drejtuesin, pjesa më e madhe kanë paguar më shumë sesa janë pranuar për shkaqe partiake, arrijnë të punësohen.

Kalojmë te shqetësimet, që lidhen me mësuesin. Te neni 16, i cili ka të bëjë me profesionin e mësuesit, në pikën 4, ndryshimet që bëhen në nenin 57 për profesionin e mësuesit, keni thënë se profesioni i mësuesit mund të ushtrohet edhe nga individë që zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë ose diplomë universitare të integruar, të ngjashme ose të përafërt me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, dhe njohuri të certifikuara në formimin psiko-pedagogjik nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar. Kujtoj se e keni quajtur si arritjen tuaj më të madhe në këtë komision, me shifra që besoj se kolegët i mbajnë mend, sa mësues jashtë profilit keni hequr nga puna në një vend apo në një tjetër (nuk i mbaj mend shifrat të sakta), por po të gjejmë procesverbalet, mund t’u referohemi. Pra, një nga arritjet tuaja më të mëdha ishte heqja e mësuesve jashtë profilit nga puna. Ndërkohë, sot na sillni disa ndryshime në ligj, që flasin për futjen në sistem të mësuesve jashtë profilit, në të njëjtin kontekst që edhe ju e keni thënë.

Kështu, nuk e kuptoj se çfarë sensi ka kjo. Pse nuk e bëtë këtë ndryshim që ju bëtë tani në ligj disa vite më parë, në mënyrë që të rakordonit ata që hoqët, me ata që duhet të jenë brenda sistemit? Kuptohet, përgjigja është një e vetme edhe për rastin e parë të mësuesit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, edhe për rastin e dytë, si të gjeni forma për të larguar disa njerëz nga

puna dhe për të vendosur disa të tjerë për të përfituar politikisht apo për përfitime të drejtpërdrejta ekonomike.

Më pas vazhdojmë me shkollën e drejtorëve, që është një gjetje e çuditshme edhe për mënyrën se si është interpretuar. Unë ju dëgjova me vëmendje. Ju iu referuat kontributit që do të japë Fondi Amerikano-Shqiptar për shkollën e drejtorëve. Nuk arrij të kuptoj se si kjo shkollë e drejtorëve, e cila do të miratohet me ligj dhe do të përgatisë ata që do të drejtojnë kyçin, bazën e të gjithë arsimit në Shqipëri, mund të konsiderohet e pavarur. Unë nuk arrij ta kuptoj të qenurit në ligj të termit “e pavarur”. E pavarur nga përgatitja e një kurrikule, të cilën e përcakton qeveria, ministria, institucionet përgjegjëse, që do t’u shkojë më pas studentëve? E pavarur për mënyrën si do të përgatitet? Unë nuk arrij dot ta kuptoj se ku qëndron termi “i pavarur”, përveçse në një kontekst, e pavarur në aspektin ekonomik. Janë mbi 2000 drejtorë që duhet të kalojnë në Shkollën e Drejtorëve. Po të llogarisim kostot e secilit prej tyre, edhe kostot informale, e kuptojmë se si është, si puna e policëve të shkretë që duhet të kalojnë në procesin e vetingut dhe paguajnë 22 mijë lekëshin. Kush e di sa do t’u kërkon drejtorëve që t’i hiqni nga puna dhe të vini disa të tjerë!

Nëse është e pavarur kjo shkollë, a do të ketë shteti ndonjë kontribut monetar në ndërtimin e kësaj shkolle? Nëse ka, si mund të quhet e pavarur?

Është edhe një çështje, që mendoj se mungon në ndryshimet që ju keni sjellë. Me miratimin e ligjit për arsimin e lartë, duhet të kishte ndërhyrje edhe në ligjin për arsimin parauniversitar, për sa i takon pjesës së maturës shtetërore, nëse ajo është dalëse apo hyrëse. Përse nuk shikojmë një reflektim në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, përderisa ju keni sjellë disa ndryshime edhe në këtë aspekt? Besoj se është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të gjithë maurantët.

Vazhdojmë me 3 shqetësime të tjera, të cilat po ashtu, janë të rëndësishme.

E para, është kërkesa për ID-të, që u keni bërë prindërve të nxënësve që studiojnë në shkollat e arsimit parauniversitar. Ky shqetësim është ngritur disa herë nga kolegët deputetë për bazën ligjore. Këtu kishim dje një nga drejtuesit e institucioneve, më konkretisht, të Hipotekës, i cili tha se nuk mund të na japë ne, si deputetë, informacion mbi disa prona që duhet të vendoset të zbardhen para publikut, sepse ruhen të dhënat konfidenciale.

Po të dhënat konfidenciale të prindërve që ju ua kërkon në mënyrë të paligjshme, të paprecedente, për t’i përdorur pastaj për arsytet tuaja private, partiake? Çfarë ndodh? Pse ka dy standarde këtu? Pse ka një standard për një çështje, që shqetëson të gjithë shqiptarët dhe nuk bëhet

transparencë mbi një pronë, e cila duhej të ishte në fakt në shërbim të qytetarëve, por në fakt u vihët në shërbim shtetarëve dhe një tjetër standard për të dhënat personale të prindërve shqiptarë, që janë parimisht e gjithë popullsia?

Nga ana tjetër, u fol këtu për mësuesit, të cilët po kthehen nga pushimet për të marrë dëftesat.

Po ashtu, kam një shqetësim të ngritur nga mësuesit e Qarkut të Tiranës, të cilëve Drejtoria Arsimore e Tiranës në kundërshtim me Kodin e Punës, ua ka ulur ditët e pushimit. A keni ju një informacion lidhur me këtë çështje? Çfarë përgjigje mund t'ju japim sot mësuesve, të cilët sipas urdhrit të DAR, Tiranë duhet të bëjnë më pak leje sesa kanë bërë sipas Kodit të Punës në vitet e mëparshme?

E fundit, për ta kthyer në vëmendjen tuaj, e tha më parë edhe profesor Shezaiu lidhur me pyetësorët që u janë shpërndarë fëmijëve lidhur me preferencat e tyre seksuale qoftë në aspektin e edukimit, por edhe në atë të shërbimit shëndetësor. Pyetësi i famshëm, që qarkullonte lidhur me përvojat seksuale që kanë pasur fëmijët. A keni qenë në dijeni dhe a mbani ju dhe institucioni që përfaqësoni, përgjegjësi morale?

Faleminderit!

Albana Vokshi - Faleminderit!

Më duhet të bëj një njoftim. Meqenëse jemi Komision përgjegjës për Mediet, dua t'ju tregoj këtë foto, ku është policia, që po u vë gjobë makinave të transmetimit. Mjetet që transmetojnë *live* me mirëkuptimin e Kuvendit, kanë qëndruar në të njëjtin vend. Siç duket kanë qenë medie që po transmetonin *live* mbledhjen e komisionit tonë dhe në çastin kur kemi diskutuar për mungesën e dëftesave për 420 mijë fëmijë, policia ka shkuar për t'u vënë gjobë makinave të tyre të transmetimit. Ky është një akt i paprecedent. U bëjmë, thirrje medieve të mos heqin dorë nga transmetimi *live* dhe nga transparenca për të gjitha veprimet, për të gjitha projektligjet dhe të gjitha politikat, që po shkatërrojnë në rastin konkret të gjithë sistemin e arsimit parauniversitar. Ky është akt i paprecedent. Keni vendosur të mos bëni transparencë ndaj publikut. Kjo nuk është gjë tjetër, veçse rënie në diktaturë. Ky është fundi, prandaj po mundoheni t'ia mbyllni gojën opozitës, një herë me kërcënime dhe tani po u mbyllni gojën medieve, që ato të mos transmetojnë *live* mbledhjen e komisionit. Unë ju tregova foton.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, do t'jua jap fjalën për procedurë.

Bëra një njoftim, sepse jemi Komision përgjegjës për Mediet.

Fidel Ylli – Faleminderit, zonja kryetare!

Për të sqaruar jo vetëm komisionin, por edhe opinionin publik, në qoftë se e patë, unë u shkëputa 10 minuta nga komisioni, pasi njëra nga punonjëset e parlamentit që mbulon mediet, e ngriti këtë shqetësim. Ajo tha se po vendosen gjoba nga policia. Jam lidhur me kryetarin e bashkisë, sepse mendova se ishte Policia Bashkiake, por rezultoi se ishte Policia Rrugore, që po u vinte gjobat. Jemi lidhur menjëherë jo me shefin e Qarkullimit Rrugor, por me ministrin e Brendshëm, i cili për 5 minuta e ka zgjidhur këtë problem.

Para se ta ngrinit ju këtë shqetësim, unë dola jashtë. Mund ta verifikoni edhe me gazetarët që janë jashtë, që u ndërhy brenda 5 minutash nga ministri dhe u tha që të mos e bëjë njeri, pavarësisht se kanë hipur mbi trotuar dhe është shkelur Kodi Rrugor, është një procedurë që po vazhdon prej 25 vjetësh, përderisa nuk ka qenë sistemi i medieve për ta marrë sinjalin në parlament, që do të bëhet shumë shpejt.

Të lutem, mos ta prishim, se nuk është bërë me qëllim!

Albana Vokshi – Sigurisht, që është bërë me qëllim.

Të falënderoj, që ke ndërhyrë!

Fidel Ylli – Polici që ka vënë gjobën, ka zbatuar Kodin Rrugor dhe nuk është në shkelje. Policia nuk duhet t'i lejojë makinat në trotuar, por ne si komision, duhet të përsheptomë punën që ajo pikë e sinjalit që do të merret nëpërmjet TVSH-së, të fillojë sa më shpejt.

Albana Vokshi – Ju sapo vërtetuat atë që unë denoncova. Është marrë urdhër të gjobiten makinat e transmetimit.

Milva Ekonomi – U anulua urdhri.

Albana Vokshi – Është anuluar, mbasi ka reaguar me një deklaratë zyrtare PD-ja.

Më vjen keq!

Ju lutem! Kini parasysh se nuk mund t'u mbyllni gojën! Kjo që po bëni është e tmerrshme. Nuk mund t'i mbyllni dot gojën opozitës. Tani po mundoheni të shantazhoni mediet, që nuk ju binden. Kjo që po bëni është e tmerrshme! Ju që përpiqeni të thoni se jeni qeveri ...

Fidel Ylli – Tani të vazhdojmë me projektligjin!

Albana Vokshi – Sigurisht. Pse, nuk të shqetëson kjo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është bërë me urdhër, zoti Ylli. Shumë mirë që ndërhyre! Ato mjete kanë 25 vjet që rrinë aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si qenka, kur nuk transmetohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni, është ndërprerë, sepse unë kam mesazhe, që thonë se është ndërprerë.

Si mund të marrim ne mesazhet dhe reagimet e mësuesve të prindërve, të mësuesve që po na ndjekin, nëse ju jepni urdhër të ndërpritet transmetimi *live*?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Milva Ekonomi - Ai urdhër i policisë u anulua menjëherë, sepse u ndërhy dhe komisioni jepet *live* nga të gjitha mediet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nuk duhet të ndodhë më kjo që ndodhi. Nuk mund të gjobiten makinat, që kanë ndenjur aty me mirëkuptimin e Kuvendit për 25 vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mos bëhet më!

Ne jemi të vendosur që të jemi transparentë.

Milva Ekonomi – Të gjitha mediet e kanë kuptuar se tani do të ketë një sistem të ri komunikimi. Ndërkohë, edhe aparaturat që kemi sot përpara prandaj patën një moment të vështirë për të filluar mbledhjen, sepse janë të reja dhe po kolaudohen....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Milva, nuk ka lidhje kjo që po thua me gjobat.

Milva Ekonomi – ... për transmetimin audio dhe video të çdo komisioni. Na është bërë me dije nga sekretari i Përgjithshëm të gjithëve me një *e-mail* para disa muajve. Të gjithë e dimë këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Do të bëjmë pyetje, Vali, por ato duhen transmetuar. Pyetjet e tua dhe shqetësimet që ngrihen këtu, a duhet t'i shohin ata, apo jo? Po sigurohemi që të gjitha mediet dhe mjetet e tyre janë jashtë. Përndryshe, kjo që thuhet këtu, shqetësimet që ngre ti, nuk kuptohen, nuk merren vesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të bëjmë transparencë dhe mediet nuk duhet të shantazhohen. Ju lutem, kuptojeni këtë! Këtu jemi në një prej funksioneve që ky komision ka, për lirinë e medias dhe për lirinë e shtypit. Çështja që unë ngrita, është shumë e rëndësishme. Nuk di ta them, zoti Ylli, nëse është më e rëndësishme media, transmetimi dhe shtypi i lirë, apo sistemi i arsimit parauniversitar, që ju po e shkatërroi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është e rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, të sigurohemi që të gjitha të diskutohen dhe të transmetohen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sigurisht, mbas reagimit zyrtar të PD-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fadil Nasufi – Faleminderit, zonja Ministre!

Unë sa herë që jam këtu, në pozicionin e deputetit, rri tërë sy e veshë nga paneli që kemi ftuar, për shumë arsye, për të respektuar autoritetin e ministres dhe stafin shumë të profilizuar dhe shumë të specializuar që ka punuar mbi 3 vjet dhe është konsultuar me të gjitha grupet e interesit, me të gjithë partnerët dhe me të gjithë ata që asistojnë projektligjet shumë të rëndësishme, siç është edhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Ju bëj thirrje t’i kushtojmë shumë vëmendje jo vetëm fjalës së zëvendësministres, por edhe specialistëve që e shoqërojnë nga pas, sepse të gjithë jemi të interesuar të mësojmë nga profesionistët dhe nga specialistët e fushës përkatëse.

E them jo pa drojë se kur dëgjoj emra profesorësh në komision, siç kemi të nderuarin Shezai, Norën, Valin apo të tjerët, gjithmonë prirem t’i dëgjoj për të gjithë bagazhin e madh të dijes që ata kanë akumuluar, si një pasuri shumë e vyer e botës akademike dhe profesoratit, por koleksionoj fatkeqësisht shumë pak prononcime profesionale, sepse të rrëmben politika e konfliktit dhe politika e partisë, që të mëson ndonjëherë gjuhën e mitingashëve në vend të gjuhës së profesionistëve.

Unë jam shumë i privilegjuar që i kam ata përballë dhe pres shumë, bile u lë kohë nga koha ime, nëse ata prononcohen realisht për një çështje kaq madhore, siç është arsimit.

E përsëris për të disatën herë, se po humbasim shumë kohë për procedurat dhe nuk po i lëmë vend përmbajtjes së ligjeve, aq më shumë projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””. Ky ligj që vjen sot, për mendimin tim, është një projektligj, i cili adreson shumë aspekte që kanë të bëjnë me cilësinë e arsimit. Ai është një proces pastrimi nga të gjitha deformimet që ka pësuar arsimit parauniversitar në vite, është një proces i spikatur përgjegjshmërie për rolin e arsimit, për rolin e mësuesit dhe për rolin e shkollës në Shqipëri, që besoj se është në thellim të rritjes së autoritetit të shkollës, të seriozitetit, por edhe të nxitjes së vetëdijes kombëtare që duhet të kemi për çështjen e shkollës që nga ciklet e fillimit, deri në ciklin e arsimit universitar.

Është një tendencë që realisht synon ta depolitizojë arsimin qoftë në aspektin e drejtimit, qoftë në aspektin e të gjithë përmbajtjes, që fillon jo vetëm me figurën e mësuesit, por edhe me tekstet që ka sot shkolla.

Ne i njohim defektet. Këtu nuk është për të bërë politikë dhe statistika se si u katandis arsimit me profesione pa profesionistë, apo në militantë që drejtojnë sot shkollat. Prandaj, në këtë aspekt, unë e mbështes këtë projektligj dhe aspektet e tjera që kanë të bëjnë me rezerva ose plotësime të kuadrit teknik apo të kuadrit praktik, siç e thashë në fjalën time më parë, i mirëpres dhe dua të dëgjoj profesionistët, pavarësisht se cilin krah politik përfaqësojnë.

Në këtë aspekt përshëndes edhe rolin e Fondit Shqiptaro-Amerikan, që është një model suksesi në Shqipëri jo vetëm për programet dhe projektet e zhvillimit të infrastrukturës, modeleve, për kontributin dhe asistencën në ngritjen e kapaciteteve dhe në formimin e një shkolle të kulturës politike në Shqipëri, por edhe për problemin e trashëgimisë. Më vjen shumë mirë që është kontribuues edhe për çështjen e krijimit të shkollës së drejtorëve.

Zonja Ministre, në këtë aspekt unë kam 3 pyetje të karakterit praktik. Ju thatë edhe vetë se për riorganizimin e ri administrativ janë krijuar 61 bashki. Po marr qarkun e Beratit. Sot kemi 3 zyra drejtorish arsimore: DAR-in e Beratit, DAR-in e Skraparit dhe atë të Kuçovës. A do të ketë zyrë arsimore bashkia e Poliçanit dhe ajo e Urës Vajguore?

Së dyti, ka një praktikë me transferimet e mësuesve. Mirë, mësuesi konkurren në sistemin e portalit dhe merr vendin e lirë, aty ku shfaqet. Më pas ndodh që mësuesi kërkon transferim për arsye afërsie, shëndeti, moshe, përvojë etj. Si bëhet ky transferim, sepse ka një ngërç midis

këshillave dhe midis procedurave, që bien pak ndesh në praktikë me procedurat e transferimit të portalit?

Së treti, për çështjen e arsimit parashkollor, edhe në ligjin organik të qeverisjes vendore, kjo kompetencë, për emërimin e drejtorëve të kopshteve apo për rekrutimin e mësuesve, i lihet qeverisjes vendore. Unë jam vetë përfaqësues i pushtetit vendor, sepse kam drejtuar një bashki, por më duket se ka shumë heterogjenitet në pikëpamjen e vendimmarrjeve të 61 bashkive, pavarësisht disa kriterëve apo disa normave, që mund të vihen për përzgjedhjen e mësuesve.

Së katërti, ka probleme të lokalizuara. Fjala vjen, një mësues që është në Berat, do të aplikojë vetëm në Berat për të gjetur vendin e punës. Ai nuk mund të shkojë në Poliçan apo në Urën Vajgurore. Ndoshta ai mund ta ketë më afër Urën Vajgurore, vetëm 2 kilometra, ndërsa Beratin mund ta ketë 20 kilometra, sepse, për shembull, mund të vijë nga Sinja dhe nuk e gjen dot vendin dhe hapësirën, ndërkohë që me statusin e nëpunësit civil, e kemi në ligj që një aplikant ka të drejtë ta gjejë vendin e punës 50 kilometra larg, sipas të drejtës që i jep profesioni për të aplikuar. Kështu, janë disa ngërçe praktike, që i ndeshim në jetën e përditshme dhe disa modalitete, të cilat nuk mund të përfshihen në ligj, por mund të përfshihen në aktet normative apo në praktikat e ndryshme, që e bëjnë të zgjidhshëm problemin dhe nuk e bllokojnë vendimmarrjen.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Nasufi!

Nuk e di pse ju duken jo të rëndësishme fjalët që morëm më parë për procedurë, për të ngritur shqetësimin e 420 mijë fëmijëve. Madje, unë mendoj se kanë pasur interes më të madh se pjesa që po diskutojmë tani, sepse si rrallë herë sot, mesazhet po vijnë në mënyrë të pandërprerë. Unë do të lexoj një mesazh, që është në përgjigje të asaj që tha ministrja pak më parë.

Dërguesi i mesazhit thotë se nuk e tregon dot shkollën, se nuk ka ndërmend të mbetet pa punë.

E dyta, kanë qenë në punë rregullisht dhe nuk kanë marrë asnjë ditë pushim. Thotë se përveç pushimeve dhe shpenzimeve, kush e paguan për stresin dhe për fëmijët që po i qajnë?

Ju vjen për të qeshur, zonja zëvendësministre?

A keni fëmijë ju?

Ju vjen për të qeshur, që fëmijët e tjerë po qajnë? Mua nuk më vjen për të qeshur. Mua më dhemb. Të gjithë kemi fëmijë dhe kur ua ndërpresim planin e pushimeve dhe çdolloj plani tjetër, që i është përkushtuar familjes, unë mendoj se kjo është për t'u shqetësuar dhe nuk është aspak

për të qeshur, sepse jo vetëm që po u shkaktoni dëm ekonomik të gjitha familjeve, por edhe dëme shpirtërore dhe psikologjike. Fakti që fëmijët qajnë, nuk mendoj se është për të qeshur.

Fjalën e ka zonja Duka!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më pas, e keni fjalën ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, Vali do të flasë më parë dhe më pas profesor Ismeti!

Valentina Duka – Zonja Ministre,

E kam lexuar me shumë vëmendjen ligjin, që keni sjellë sot për diskutim. Kam një konstatim që në fakt, e kam për të gjitha ligjet që kam pasur fatin t'i lexoj në këtë komision. Ligjet janë përgatitur shumë keq nga pikëpamja e teknikës ligjore. Kjo do të thotë që administrata e lartë apo Zyra Juridike nuk i njeh teknikat adekuate të përgatitjes së një ligji. Kam punuar mbrëmë dhe e kam krahasuar këtë ligj edhe me ligjet e vendeve fqinje, edhe me ligjin e Kosovës dhe ju them se kemi shumë mangësi në mënyrën se si i përgatisim dispozitat dhe nenet e ligjit.

Së dyti, kam disa pyetje shumë të rëndësishme që mua më kanë dalë nga shfletimi i ligjit. Bashkohem me shqetësimet e kolegëve të mi për sa i përket portalit për mësuesit. Unë mendoj se baza ligjore mbi të cilën ky ka vepruar deri tani, nuk na u shpjegua siç duhet. Mund të na e thuash edhe një herë, zonja Ministre, pse ka vazhduar të funksionojë për një kohë të gjatë, mbështetur në një udhëzim të ministrit dhe pse nuk e keni bërë pjesë të ligjit më parë? Kështu siç ka funksionuar, ka lënë vend për mangësi dhe për emërime politike në fushën e mësuesisë.

Së dyti, për sa i përket nenit 25, funksionet kryesore të ministrisë suaj, keni vetëm pesë pika shumë të mangëta, ndonjë prej tyre edhe pa kuptim. Do të lexoj germën “d”: “Hartimi, zbatimi, vlerësimi i ndikimit të kuadrit rregullator të sistemit arsimor parauniversitar”. Lakonike, e paqartë dhe e pashpjeguar siç duhet veprimtaria e institucionit tuaj.

Zonja Ministre, a mund të shpjegohen funksionet kryesore të ministrisë suaj vetëm në katër pika, kur ligjet e tjerë kanë mbi 30 pika? Institucioni juaj ka funksione të tjera të rëndësishme dhe të qenësishme, që duhet të ishin këtu: mënyra se si ju qeverisni për të kapërcyer diskriminimin që mund të ndodhë te nxënësit, se si ju bëni kontrollin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, se si ju organizoni vlerësimin e nxënësve nëpër shkolla, qëndrimi që ju do të mbani te fëmijët me probleme, se si ju nënshkruani kontrata ... Këtu ju thoni “vetëm me institucionet”, por me kë, ato

brenda Shqipërisë, jashtë Shqipërisë, brenda Shqipërisë me institucione shtetërore apo jo shtetërore?

Pra, kështu sikundër ju keni organizuar funksionet kryesore të ministrisë, ju, në fakt, nuk keni shprehur realisht punën që bën institucioni juaj në interes të sistemit parauniversitar.

Pyetja tjetër që lidhet po me nenin 25 është: Para se të di funksionet kryesore të institucionit të varësisë, cilat do të jenë institucionet kryesore të varësisë që ju do të keni? Kur do të ngrihen dhe si do të ngrihen?

Një pikë shumë delikate e këtij neni është shkolla e drejtorëve. Para se të jap ndonjë mendim për shkollën e drejtorëve, dua të di se cila eksperiencë botërore është marrë si shembull për ngritjen e shkollës së drejtorëve: eksperiencia europiane apo eksperiencia amerikane? Cila nga këto eksperiencia është e ngjashme me këtë që ju do të ndërtoni në Shqipëri? Ku do të afilohet kjo shkollë? Nga ato që di, nëse funksionon, në Amerikë është afiluar pranë universiteteve. Kjo shkollë do të afilohet pranë ndonjë universiteti, publik apo privat, dhe mbi çfarë baze ligjore do të ndërtohet? Pse na duhet një shkollë për drejtorë kur kemi eksperiencë shumë negative me shkollën e kuadrove të sistemit komunist? Pse të mos zëvendësohet kjo me ndonjë master për krijimin e menaxherëve të arsimit, siç ka në shumë universitete europiane dhe amerikane? Cili është vizioni juaj për krijimin e kësaj shkolle?

Kam një pyetje tjetër për Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar. Kush e nominon dhe pse nuk bëjnë pjesë këtu përfaqësues të universiteteve dhe të sindikatave, siç bëjnë pjesë në të gjitha këshillat kombëtarë të arsimit parauniversitar, të paktën në vendet e Ballkanit, ligjet e të cilave unë i kam lexuar? Si do të menaxhohet nga pikëpamja administrative Këshilli Kombëtar që ju do të krijoni?

Këshillin Kombëtar të Prindërve unë e mbështes si institucion, por në dy nenet që keni këtu nuk na shpjegoni se sa anëtarë do të ketë ky këshill dhe si do të nominohen këta anëtarë? Sa do të jetë kohëzgjatja e një anëtari të këshillit të prindërve në këtë këshill? Si do ta zgjedhë këshilli kryetarin e tij? Në qoftë se nuk i përcaktoni këtu dhe ia lini rastësisë, këshilli i prindërve mund të kthehet në një këshill politik.

Për sa i përket buxhetimit, në nenin 9 për mënyrën si do të buxhetohet sistemi parauniversitar, ju mendoni se keni një arritje në raport me mënyrën se si buxhetohej ajo më parë. Përveç të ardhurave nga të dytë, që mund t'u vijnë shkollave, të ardhurat e tjera që mund të vijnë nga fondacione dhe projekte si do t'i menaxhojë shkolla, sepse këtu nuk e shpjegoni? Këtu thoni

“të ardhura që mund të sigurohen nga taksat”, por nuk thoni si do t’i menaxhojë shkolla të ardhurat që do të sigurojë nga projektet.

Neni 12 për diasporën. Mua më vjen shumë mirë që ligji i arsimit parauniversitar do të ketë një nen për diasporën, por ju nuk shpjegoni nëse Ministria e Arsimit do të financojë apo jo shkollat shqipe që ndërtohen dhe që funksionojnë në diasporë. Këtu nuk thuhet asnjë fjalë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pyetja tjetër, zonja Ministre, ka të bëjë me studentët që mbarojnë mastera shkencorë jo në fushën e mësuesisë. E kuptoj që ligji do t’u krijojë hapësira për t’u futur në sistemin e mësimdhënies, por si do të integrohen këta? Cilat nga institucionet do t’u krijojnë këtyre mundësinë për të marrë kreditet në fushën e psikologjisë, që atyre u mungon dhe si do t’i zhvillojnë praktikat mësimore, në mënyrë që të lejohen të hyjnë te konkursi i licencimit për mësues? Ky ligj i përfshin ata, apo jo? Si mund të ketë një dispozitë kalimtare, që kriteri i trajnimit të pajisjes me certifikatën e drejtuesit të institucionit të arsimor parashkollor, sipas nenit 15, hyn në fuqi pas 4 vjetëve? Këtë ligjërisht nuk e kuptoj.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, Valentina!

Luçiano Boçi – Më falni, sepse po dal nga rrjedha e debatit, por e kam për çështjen që u ngrit pak më parë nga kryetarja e komisionit në lidhje me gjobitjen e mediave. Mua më vjen mirë që është interesuar zoti Ylli, por nuk jam dakord me mekanizmin. Jepet urdhër për të vënë gjoba, merret urdhër të tërhiqen gjobat. Ndërkohë, edhe tërheqja e gjobave është bërë në mënyrë selektive. Unë kam në inboksen tim gjobën që i është vënë njërit prej televizioneve që transmeton drejtpërdrejtë, e cila nuk është hequr. Mënyra me urdhër, meqenëse doni ndonjë shprehje që përdor kryeministri juaj, “nuk ka ndodhur asnjëherë në këto 20 vjet”, thotë ai, sepse nuk e di numrin 27. Shumë mirë që jeni interesuar, por mënyra e zgjidhjes, unë marr ministrin, ministri e zgjidh çështjen, është absurde. Kështu bëhen gjërat në Shqipëri? Kjo media gjobitet, kjo nuk gjobitet. Është skandaloze. Gjoba është e shkruar dhe ekziston. Kërkova ndjesë për ndërprerjen, por situata e lirisë së fjalës duhet të na shqetësojë edhe për transmetimin direkt dhe gjërat e tjera. Pra, jemi në një situatë alarmante. Unë kërkoj publikisht që të gjendet një modalitet, me urdhër, pa telefon, në mënyrë ligjore, që gjoba të quhet e pavlefshme, sepse edhe mënyra me telefon nuk funksionon.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Fjalën e ka profesori, Ismeti dhe, më pa, s ju.

Shezai Rrokaj – Faleminderit!

Në fakt, kur bëhet fjalë për çështje sociale të tilla siç është arsimi kombëtar, asnjëherë politika nuk duhet ta vështrojë veten në mënyrë egoiste dhe me këtë jam shumë i qartë dhe dua të mirëkuptohem nga kolegu Nasufi. Politikë e mirë është ajo që i shërben politikës kombëtare të arsimit kombëtar. Thënë kjo, duhet që të gjitha aktet normative që dalin, që nga ligjet e deri tek aktet normative, duhet të zbatohen dhe jo vetëm të thuhën, hartohen apo miratohen në Kuvend. E bëra këtë parashtrim për të vënë në dukje 2-3 gjëra ndaj të cilave, më besoni zonja Ministre, personalisht jam shumë i ndjeshëm, sepse janë probleme të gjithë shoqërisë sonë.

E para, në nenin 2, që i referohet nenit 25, për ndryshimet përkatëse në faqen 2 të amendimeve, në germën “d” ju shpreheni qartazi se financimi i sistemit arsimor parauniversitar i duhet lënë Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve. Po ta besojmë këtë si të vërtetë, mjafton t’i referohemi strategjisë së arsimit parauniversitar, që e kemi miratuar së bashku kur ishim në qeverisje në vitin 2014, ku kemi thënë që në vitin 2018 do ta financojmë arsimin parauniversitar me 3% të prodhimit të brendshëm bruto. Nuk e kemi bërë. Nuk është e vërtetë. Nuk është arritur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo në fund të mandatit, të lutem Bujar, unë jam shumë i saktë në këto që them.

I gjithë arsimi nuk është te 3%-i. Pra, themi disa gjëra që ngelen vetëm në letër. Po te strategjia, zonja Ministre, keni thënë që për nxënësit me aftësi të kufizuara në vitin 2018 do të duheshin 300 arsimtarë. Janë shifra të cituara. Jo vetëm kaq, por aty është thënë që do të ndërtoni një kurrikul për arsimtarët që do të destinoheshin në këtë punë. Nuk e keni ndërtuar. Deri më sot ne nuk kemi nxjerrë arsimtarë me këtë kurrikul. Janë ndërhyrje të pjesshme të lëndëve që u jepen krahas këtyre.

Kështu që, kemi një problem të madh midis asaj që themi dhe asaj që realizojmë në të vërtetë, siç ishte, për shembull, prirja e mirë që në ligjin e arsimit të lartë të vendosej një dysHEME për pranimet në universitet. Dy vitet që kanë kaluar është vendosur si dysHEME nota 6. Këtë vit është shtuar edhe një qëndrim tjetër, nota 7 për sa i përket mësuesisë. Po t’i shikosh në parim, nuk ka gjë të keqe, por fakt është që jetojmë në Shqipëri. Në Shqipëri, nga një verifikim që unë kam bërë me statistika të dhëna prej jush, më rezulton që vendosja e notës 6 ka rritur fiktivitetin në maturat 2016-2017, për këtë maturë nuk kam të dhëna, 4% çdo vit, që do të thotë 8%. Me pak fjalë, është pakësuar numri i nxënësve që kanë mesatare nga 5-6 dhe është rritur numri i nxënësve

me mesatare nga 6-7. Këto janë të dhënat tuaja, të cilat ne nuk kemi pse i fshehim, sepse është mirë që t'i rregullojmë dhe të kemi parasysh që nuk mjafton që ne të bëjmë një ndryshim. Ne duhet të bëjmë ato ndryshime që realisht kanë efektivitet.

Më shqetëson, sikundër edhe kolegja Duka e tha, shkolla e drejtorëve. Më shqetëson pse përzgjidhet një fondacion. Të më kuptojnë përfaqësuesit e fondacionit, sepse absolutisht nuk kam asgjë personale me ta, por duhet të më kuptojë edhe opinioni publik, që ky fondacion nuk është i orientuar në fushën e arsimit. Është një fondacion jofitimprurës që ofron mbështetje tek ne në drejtime të caktuara. Pra, pse parapërcaktim? Pse nuk ia lëmë këtë kompetencë Ministrisë së Arsimit dhe pse në relacion nuk dimë sa do të paguajnë drejtorët? A do të jenë vetëm këta drejtorë apo do të fillojnë nga e para? Çfarë do të bëhet? Pra, ka shumë paqartësi, sepse aty thuhet që ministria do të ketë rolin monitorues. Nuk mund të ketë thjesht vetëm të drejtën e monitoruesit Ministria e Arsimit, sepse ... Kjo është shkollë dhe duke qenë e tillë, patjetër që duhet të jetë në varësinë e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Arsimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është kurrikul. Ka elemente shumë të paqarta dhe për mendimi tim duhen trajtuar.

Për sa i përket portalit, unë jam i bindur që edhe ju keni imputet e duhura. Te ne, përtej fjalëve të bukura, gjithmonë ka një realitet tjetër midis asaj që është dhe asaj që shfaqet, që portali është dhe vazhdon të jetë ende nën tryshninë, siç ka qenë administrata jonë, të politikës dhe të korrupsionit. Ky është realiteti. Unë nuk vë gishtin në emra të përveçëm, sepse duhet të kem fakte të mirëqena, por portali nuk e ka zgjidhur, këtë e them me shumë bindje nga kontakte me mësues, problemin e meritës së individit përballë të drejtës së punës dhe se portali është në mënyra të tërthorta i ndikueshëm nga ata që bëjnë përzgjedhjen, ku, për fat të keq, në konceptin tim profesional, komisioni që përzgjedh mësuesin ka vetëm dy profesionistë. Nuk ka kuptim që profesionalizmi t'i nënshtrohet grupimeve të tjera që janë pjesëmarrës në përzgjedhjen e mësuesit. Do të thotë se numri i profesionistëve që vendosin për mësuesin është inferior në raport me numrin e pjesëmarrësve të tjerë të komisionit në përzgjedhjen e tij.

Kështu që, unë do të kërkoja në të gjitha rastet që sa herë flitet për mësues dhe për fushë, në komisione të dominojë profesionalizmi, qoftë edhe i zgjedhur nga kolektivi, në raport me numrin e tyre, sepse vetëm kështu unë them dhe jam i bindur që një profesionist, sado politik të jetë, mbetet profesionist. Kur e zgjedh i gjithë kolektivi, ne duhet të kemi aq besim te kolektivat tona të mësuesve për zgjidhje të drejta të kësaj.

Kështu që, ajo që më shqetëson , zonja Ministre, përtej fjalëve të bukura që ne i themi në komunikimet tona, është që nuk kemi pse ta përdorim politikën aq shumë sa për të rritur maksimalisht PR-në e secilit prej nesh, sepse besoj, si ju dhe shumë të tjerë, që merita jonë më e madhe është çfarë kontributi real ne do të japim për arsimin, i cili, siç e thashë në krye të kësaj fjale, është përtej dimensioneve të partive të spektrit politik, sepse është një e mirë kombëtare.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Po, Ismet!

Më pas e kanë fjalën Luani, Romeo, Luçiano, Milva dhe Bujari.

Ismet Beqiri – Duke u hedhur një sy dokumenteve, që kur është ngjizur ligji për arsimin parauniversitar, kjo është ndërhyrja e katërt nga ligji bazë i vitit 1995 që është bërë në sistemin e arsimit parauniversitar: 1995, 2012, 2015, tentativë në vitin 2017 dhe përsëri në vitin 2018.

Kjo do të thotë që, edhe pse ka pasur një ligj, gjërat që janë të vështira dhe të rëndësishme, sigurisht që kanë pasur, kanë dhe do të kenë probleme. Këto ndryshime kanë synuar të përmirësojnë funksionimin dhe organizimin e institucioneve përgjegjëse të arsimit parauniversitar, sikurse edhe projektligji që u paraqit tani.

Ndaj, e kam thënë edhe herë të tjera, ta shikojmë gotën gjysmë plot. Unë e komplimentoj stafin dhe drejtuesit e institucionit përkatës, ministren dhe bashkëpunëtorët e saj për këtë draft, që ka ndryshim thelbësor nga drafti që u paraqit 6-7 muaj më parë, që pasqyron nismat që janë ndërmarrë, problematikën që ka lindur në terrenin konkret të këtij sektori të rëndësishëm jo vetëm në zonat urbane, por edhe ato rurale. Nuk po themi që ndryshimet që bëjmë sot nuk do të kenë nevojë për t'u thelluar dhe përmirësuar, sidomos në kuadër të njësimin të legjislacionit tonë me legjislacionet e vendeve të Bashkimit Europian.

Unë nuk do të ndalem te qëllimi dhe synimet që ka projektligji, por më tërhoqën vëmendjen risitë që sjell ky projektligj.

Risia e parë është që ky projektligj me ndryshimet e tij sjell një qasje të re për funksionimin dhe organizimin e institucioneve të arsimit parauniversitar.

Risia e dytë, propozohet zbatimi i konceptit të vlerësimit të jashtëm të arritjeve në shkollë në arsimin fillor, që bëhet për herë të parë.

Risi tjetër është që projektligji mundëson krijimin e bazës ligjore për një strukturë të re të prindërve në nivel kombëtar, Këshilli Kombëtar i Prindërve. Me të drejtë u bë një pyetje nga

profesoreshë Valentina, se kur parashikohet që ministria nxjerr urdhra dhe akte nënligjore për ta rregulluar dhe organizuar këtë structure.

Risi tjetër e projektligjit është se ai do të krijojë mundësinë konkrete për institucionet e arsimit parauniversitar për krijimin dhe vetëadministrimin e të ardhurave, që këto institucione kryejnë ndaj të tretëve. Kjo është risi, pasi me ligjin aktual, këto institucione, nuk kanë të drejtën të blejnë një shkumës, furçë apo fshesë, për të mos llogaritur gjëra të tjera që shërbejnë për qëllimet e edukimit dhe të formimit profesional.

Decentralizimi i kompetencës drejt pushtetit të qeverisjeve lokale, ku kemi menaxhimin e punonjësve mësimor për sistemin parashkollor, si dhe të drejtën e emërimit dhe të shkarkimit të drejtuesve të këtyre institucioneve nga kryetarët e bashkive. Kjo nuk ka qenë ose ka qenë evazive deri dje, i dimë edhe problemet që kanë ndodhur. Ministria është përgjegjëse për certifikimin profesional dhe kriteret profesionale që duhet të kenë këto kandidatura dhe kjo definohet. Pra, ndahet shapi nga sheqeri.

Përmirësimi, është një risi tjetër e kriterëve dhe standardeve profesionale të drejtuesve ose lidershit, të institucioneve të arsimit parauniversitar, mbi bazën e aftësisë dhe të kompetencës së certifikimit profesional dhe për këtë është përdorur termi. Hajdeni të gjejmë një term tjetër më të përshtatshëm dhe oportun se sa shkolla e drejtorëve!

Ajo që më tërheq vëmendjen në këtë risi është depolitizimi i plotë sistemit të drejtimit të funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë. Të gjithë i dimë, të mos bëjmë të paditurin, ndikimet politike ku edhe vetë zonja ministre e pranoi. Kjo është e vërteta, doni apo nuk doni, ne, maxhoranca e themi realitetin, ky sistem i certifikimit profesional me kriterë të qarta, sidomos ne që e kemi objekt të punës sonë profesionale punën me arsimin, pavarësisht nivelit se ku jemi, e shikojmë konkretisht se si është niveli poshtë.

Nga ana tjetër me këtë projektligj krijohet mundësia për të marrë në konsideratë të gjitha burimet njerëzore, që nuk kanë titullin e mësuesisë, për të cilat unë kam disa sugjerime, por do t'i them në momentin e caktuar. Kjo gjë është propozuar edhe nga një anëtar i nderuar i opozitës dhe unë e respektoj.

Një gjë tjetër, projektligji krijon regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, bëhet për herë të parë. Ministria e tha, por ju nuk e late, me kakofoninë që krijuat.

Albana Vokshi – Përsërisni relacionin. Po përsërisni relacionin. Keni pyetje?

Ismet Beqiraj- Nuk kam ndërhyrë në minutazhin e asnjërit. Po e them që të më dëgjojnë qytetarët, mësuesit.

Albana Vokshi - Mësuesit e kanë dëgjuar, i dinë shumë mirë.

Ismet Beqiraj - Unë e di që nuk ju pëlqen të dëgjoni risitë se çfarë sjell ky projektligj.

Albana Vokshi - Na i tha ministrja. Po merr rolin e ministres tani?!

Ismet Beqiraj - Të lutem!

Albana Vokshi - Ke pyetje?

Ismet Beqiraj - Mos më ndërhy!

Albana Vokshi – Të ndërhyj, se je gabim në procedurë.

Ismet Beqiraj - Këtu u anatemua nisma...

Albana Vokshi – Ju lutem, jemi te pyetjet!

Ismet Beqiraj -Nisma portal “ Mësues për Shqipërinë”, ajo mund të ketë defekte në ekzekutim, në zbatim, këto janë gjëra që korrigjohen.

Albana Vokshi – Jo defekte, por ai është një mashtrim.

Ismet Beqiraj - Ju lutem!

Albana Vokshi - Ai është një portal mashtrues. Është mashtrim i madh. Asnjë nuk emërohet nga portali.

Ismet Beqiraj - Zonja Albana, që po ndërhyni, jo vetëm neve, por edhe juve nesër ua heq mundësinë të fusni duart...

Albana Vokshi – Deri tani paska qenë e paligjshme! Si mund ta thoni? A të shikojnë ata mësuesit atje, nga vjen ti?

Ismet Beqiraj - Mos më ndërhy!

Albana Vokshi- Bëj pyetje!

Ismet Beqiraj - Nisma lidhur me rekrutimin në sistemin e arsimit, ka mundësi të bëhet edhe në nivele të tjera. Larg duart e politikës!

Albana Vokshi - Po, zarfi te dora ose tesera e partisë!

Ismet Beqiraj - Larg duart e politikës për të çuar militantët, edhe tuajt, edhe tanët! Unë do të sugjeroja...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Zoti Ismet, kujdes me etikën!

Ismet Beqiraj - Ju lutem! Edhe ju kujdes me etikën, kur flisni!

Albana Vokshi - Nuk i drejtohesh dot asnjë deputeteje tjetër...

Ismet Beqiraj- Unë nuk i ndërhyj asnjërit! Edhe ju kujdes me etikën!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi- Mos iu drejto zonjës Mehmetaj në atë mënyrë! Kini kujdes, sepse ka një komision etike dhe ne do të dërgojmë ankesë! Kujdes kur flet me deputetet, sepse është e re, por është 100 herë më e zonja se shumë të tjerë në këtë sallë.

Ismet Beqiraj - Edhe tani kur i ndërhyni tjetrit është fyerje, fyerje etike është edhe ndërhyrja. Si është kur i ndërhyni tjetrit?

Albana Vokshi – Ju ndërhyni gjatë gjithë kohës. Ti rrëmben mikrofonin, mirë që nuk e këput!

Ismet Beqiraj- Të lutem! Kam disa sugjerime...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, mos ndërhy! Krenarinë e kam objekt pune! Jam shumë i lumtur!

Zonja Ministre, do të sugjeroja te neni 26, lidhur me urdhrat dhe udhëzimet për zbatimin e reformës në sistemin e arsimit, duhet ta rishikoni dhe ta plotësoni edhe për nismat e reja për të zbatuar jo vetëm reformat, por edhe programet e qeverisë dhe detyrimet që kanë të bëjnë me reforma dhe me nisma, sepse anatemuam disa nisma në fillim të këtij viti. Pa pyesni njëherë nxënësit? 420 mijë nxënës, pyetini njëherë tani se çfarë thonë për ato nisma?

Të pyesim zonjën kryetare se çfarë thonë vajzat e saj? Çfarë thotë vajza ime që është në shkollën 9-vjeçare për ato nisma?

Nisur nga situata në terrenin konkret, sidomos në zonat rurale, janë dy fenomene lidhur me braktisjen e shkollës për shkak të cilësisë së mësimdhënies edhe popullimit; sugjeroj të shikohet mundësia edhe në aspektin juridik që në këtë projektligj të mundësohet krijimi i shkollave rajonale.

Te neni 61, nëse nuk gaboj “Të drejtat dhe detyrat e nxënësve” të sigurohet edhe transporti. Të mos lihet në mënyrë evazive në funksion të qeverisjes vendore, pasi kjo gjë mendohet e fundit.

Lidhur me ndryshimet që keni sjellë, neni 57, në projektligj është neni 16, ku është pasur qëllim që t’u jepet mundësi edhe kontingjentit të specialistëve që mbajnë diplomën *bachelor*, cikli i parë dhe cikli i dytë universitar, por nuk kanë licencën e mësuesisë, si edhe diplomën e

integruar universitare, t'u jepet titulli, përveç atyre që tha zonja Duka, të cilën e mbështes, do ta shikoja edhe në një kënd tjetër. Duhet të vendosen disa filtra të dendur juridikë në këtë projektligj, në mënyrë që të mos t'u hapet jo dera, por një vrimë gjilpëre kontingjenteve që kanë dalë nga universitetet kioska dhe me nivel të ulët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi- Po kanë të njëjtat diploma!

Ismet Beqiraj – Të vjen keq për universitetet kioska? Nuk besoj të kesh marrë pjesë në to.

Albana Vokshi- Unë e kam nga Columbia, por ka disa të tjerë këtu në këtë sallë që e kanë nga këto kioskat, që thua ti.

Ismet Beqiraj - Kam një sugjerim tjetër për projektligjin, e tha edhe zoti Rrokaj, edhe unë do ta përforcoj, sidomos për formimin në institucionet e arsimit të lartë të programit të mësuesisë, ku të vendoset nota minimale e të drejtës së konkurrimit në to. Duam mësues të aftë dhe të zotë në të gjitha fushat. Të mos e lëmë në mënyrë evazive që kush ministër apo qeveri që vijë, të luajë me cilësinë e mësimdhënësit dhe të profesionit të shenjtë që është mësuesi.

Faleminderit!

Albana Vokshi - Ke bërë një relacion të shkëlqyer. Edhe më të mirë sesa ministrja e ke bërë. Ka vetëm një replikë zonja Mehmetaj.

Kejdi Mehmetaj - Në fakt, si studente që jam, jam shumë krenare. Kam një sugjerim për komisionin, se pashë që edhe zonja ministre po e dëgjonte kolegun me shumë vëmendje, që ta mandatojmë kolegun deputet të marrë portalin “Për Shqipërinë” ta bëjë “Mësues për Shqipërinë” dhe ta çojmë në një konkurs ndërkombëtar...

Albana Vokshi – Që të marrë çmim.

Kejdi Mehmetaj -...me kaq vlera sa kishte...

Ismet Beqiraj – Unë e kam zbatuar në Mallakastër, po ti ku e ke zbatuar?

Kejdi Mehmetaj- Me qetësi!

Ismet Beqiraj - Me shumë fanatizëm, si pedagog që jam nuk bëj kompromis...

Albana Vokshi- Po si ka mundësi që nuk lë njeri të flasë?! Të lutem!

Kejdi Mehmetaj - Jam shumë e sigurti që me përgatitjen që na tregoi profesori, do t'ia kalojë edhe atij që mori medaljen te sheshi “Skënderbej”!.

Albana Vokshi – Po, zoti Baçi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj - Të lutem!

Albana Vokshi - Nuk ta kam dhënë fjalën. Fjalën e ka zoti Baçi.

Mos më thuaj “ të lutem”, fare!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj- Të paktën të mos fyejë! Më tepër për etikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ajo është vajzë e re. Je goxha burrë, nuk ka logjikë.

Të lutem! Nuk ta kam dhënë fjalën! Mbylle mikrofonin!

Luan Baçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Për ta sjellë në hulli mbledhjen e komisionit, se filluam përsëri nga debatet, për rëndësinë e këtij projektligji ne, si opozitë, e treguam edhe dje me mosmiratimin e rendit të ditës të të gjithë javës, për arsyen e ngarkesës.

Problematikat janë të shumta, të ndryshme dhe nuk mund të kapen të gjitha një nga një. Unë do të përqendrohem në dy-tre, pa padashur as të mbivendosem tek ata që kanë folur më parë, por as duke i kapur të gjitha problemet, siç i kapën shumë kolegë, që të mos përsëriten 2-3 herë. Flasim për një qasje të re të strukturës së sigurimit të cilësisë së mësimi. Sipas informacioneve që kemi, Inspektorati Shtetëror i Arsimit ka rreth një vit i pezulluar, sikur nuk ekziston. Flitet për ndryshimin e tij, zëvendësimin e tij. A ka një arsye dhe një raport nga Ministria e Arsimit për të gjitha këto problematika që janë sjellë për mosfunksionimin e këtij inspektorati? Është një gjë që duhet të shihet. Nuk e di, ndoshta mund ta nxirrni si problematikë, ka qenë dhe vazhdon të jetë një inspektorat që drejtohet nga ish-aleatët tuaj të LSI-së, me sa di unë, nëse nuk e kam informacionin e gabuar.

Një problem tjetër që doja të trajtoja te neni 55, i ligjit të vitit 2012, neni 6, për emërimin e drejtuesve të institucioneve. Kërkoj vëmendjen tuaj, zonja Malaj, po flisni pa mikrofon dhe nuk dëgjoheni, të paktën mos më ndërprisni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tek emërimi i drejtuesve të institucioneve, ka një ndryshim për emërimin e drejtuesve të institucioneve parashkollore: drejtorët e kopshteve parashkollore do të emërohen nga kryetari i bashkisë. A bie ndesh me frymën e ligjit, kur ky i fundit parashikon që të gjithë drejtuesit e tjerë të institucioneve do të emërohen me konkurs dhe me institucione të veçanta, ndërsa drejtuesit e

institucioneve parashkollore do të emërohen nga kryetari i bashkisë? Jam plotësisht dakord me decentralizimin dhe kalimin e kompetencave pushtetit vendor dhe nuk po e mohoj askush këtë, por emërimi që bëhet direkt nga titullari i bashkisë, në këtë rast nuk ka më decentralizim, por një individ që është kryetari i bashkisë, pavarësisht se është i zgjedhur. A nuk mund të kishte një mundësi tjetër, të kishte një komision të posaçëm, qoftë dhe brenda bashkisë, për emërimin e këtyre drejtuesve të institucioneve? Këtu ka një mospërputhje të ligjit. Mua më duket se ligji përdor dy standarde në emërimin e mësuesve.

Në pikën 2 të këtij neni, projektligji shton certifikimin e drejtorëve. Në certifikimin e tyre në ligjin e vitit 2012 drejtori, sidomos nëndrejtorët e shkollave kanë qenë arsimtarë, pjesë e mësimdhënies. Certifikimi i drejtuesve do të bëhet në bazë të këtij ligji me shkolla të posaçme, aq më tepër kur shtohet aty se do të jenë drejtues jo të politizuar, të mos jenë pjesë e forumeve të partive politike. Kjo është një gjë e mirë, por a ka një përcaktim të qartë, se cili quhet forum i partive politike? Me sa di unë nuk ka nevojë të jesh anëtar i një forumi të një partie politike. Kemi pasur raste, për t'i thënë gjërat siç janë, ju e keni shumë të zhvilluar këto kohët e fundit, që mund të jetë thjesht një anëtar i partisë ose simpatizant dhe mund të jetë vërtet i çuditshëm në vendimmarrjet e tij si drejtues, sepse është militant i thekur dhe i flaktë. Këtu duhet të përcaktohet se çfarë është "forum". A do të parashikohen në rastet e shkeljes masa ndëshkuese për ata drejtues që do të certifikohen si jo të paanshëm, si të papolitizuar, pasi ky ligj të hyjë në fuqi? Në ligj nuk parashikohet asnjë gjë e tillë. Kjo të lë shkak se duket sikur është një artificë dhe nuk sjell ndonjë gjë të re, përveç asaj që jep një imazh sikur vërtet kemi një depolitizim të drejtuesve. Me sa di unë, sipas një informacioni që kam, në Fier rreth viteve 2002-2003 është eksperimentuar puna e certifikimit të drejtuesve të shkollave, është bërë njëfarë eksperimenti në atë periudhë për disa drejtues dhe nuk pati sukses, rezultoi i dështuar totalisht. Është një informacion i plotë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Rista, absolutisht nuk mund të flisja në ajër. E kam marrë informacionin nga punonjësit tuaj që punojnë atje ende; ka punonjës të ndershëm që e japin informacionin, por nuk prononcohen. Mos u çudit fare për këtë që them, se nuk po e them në ajër. Të jesh e sigurt për këtë pjesë.

Pak a shumë këto kisha.

Ju falënderoj për vëmendjen jo të duhur këtë radhë, por me shpresën se duhet t'i keni dëgjuar.

Albana Vokshi – Po, zoti Gurakuqi. Pastaj fjalën e kanë kërkuar zonja Ekonomi, zoti Boçi, zoti Çela, zonja Malaj dhe zonja Rista. Më pas, do t'ia japim fjalën ministres që të përmbledhë përgjigjet. Në fund, do të kalojmë në shprehjen e grupeve.

Romeo Gurakuqi- Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Ministre, 102 vjet më parë në Shkodër është themeluar Drejtoria Rajonale Arsimore dhe prej 102 vjetësh në këtë qytet funksionon një qendër drejtimi e arsimit, fillimisht për të gjithë Shqipërinë, pastaj për qarkun e Shkodrës. Kërkoj të di nga ju në mënyrë definitive: në kuadrin e procesit të rajonalizimit që ju me të drejtë do ta ndërmerri, a do të qëndrojë Drejtoria Rajonale e Arsimit në Shkodër apo keni vendosur të përdorni pozicionin tuaj të deputetes së qarkut të Lezhës për ta zhvendosur për herë të parë pas 102 vjetësh Drejtorinë Arsimore nga Shkodra në drejtim të Lezhës? Është një gjë me rëndësi publike dhe dua që ju të komunikoni me publikun e Shqipërisë së Veriut në këtë moment.

Së dyti, disa herë në këtë sallë ju kam kërkuar që së paku 12 gjimnaze në 12 qarqe të Shqipërisë dhe një universitet cilësor shtetëror duhet ta ketë Shqipëria, ku prindërit shqiptarë të kenë mundësi të dërgojnë studentët. Këtu, nënkuptoj për gjimnazet e klasit të parë, me mësuesit më të mirë të republikës. A keni bërë ndonjë lëvizje konkrete në këtë drejtim për të sendërtuar një sistem solid në aspektin e arsimit cilësor parauniversitar dhe universitar në Shqipëri?

Së treti, portali dhe lëvizjet. Unë e di që një pjesë e lëvizjeve brenda portalit janë respektuar, por ju them me përgjegjësinë maksimale se të gjitha lëvizjet paralele brenda drejtorive arsimore në të gjithë vendin nuk janë zhvilluar pa ndërhyrjen e deputetëve socialistë, të cilët kanë marrë violinën e parë, para jush në procesin e lëvizjeve, këtu kam parasysh qarkun e Shkodrës. Si keni arritur të ndërprisni ndërhyrjet e deputetëve socialistë në lëvizjet paralele jashtë portalit në emërimet e profilit politik?

Të vijmë te projektligji që keni sjellë. Zonja Ministre, do t'i marr nenet me radhë dhe kërkoj vëmendjen tuaj. Duke u nisur nga neni 1, që përkon me ndryshimet e neneve...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Ekonomi, të lutem!

Është shumë e rëndësishme; nuk do të them asgjë më shumë se sa kemi vendosur. Janë certifikuar, jua thashë edhe më sipër, drejtuesit militantë.

Neni 1/25, portal "Mësues për Shqipërinë" duhet të ketë transparencë për rankimin, për kandidatët dhe për punësimin e tyre, pasi nuk ekziston kjo transparencë.

Neni 2 për nenin 25 "Funksionet kryesore të institucioneve të varësisë". Kush e garanton cilësinë e produkteve të sistemit parauniversitar? A ka një bord specialistësh për vlerësimin e produkteve? Kujt i shërbejnë projektet me shifra marramendëse në të cilët janë përfshirë njerëz edhe të paarsimuar, të pashkolluar dhe që nuk përbëjnë elitën e arsimit dhe të specialistëve të arsimit parauniversitar?

Neni 27/1 "Shkolla e drejtorëve". Profesor Rrokaj dhe zonja Duka ju përmendën me radhë rastin e shkollës së drejtorëve.

Zonja Ministre, si shpjegohet që drejtues i kësaj shkolle është këshilltari juaj? Unë e di që e keni bërë një kualifikim paraprak.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi- Tani ose mbajuni fjalës pilot, që është e njëjta, ose asaj që e keni inauguruar, ose mbajuni te kjo që është e re fare, sepse ka një kakofoni pa lidhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Romeo Gurakuqi - Zonja Ministre, sistemi aktual i drejtimit të shkollave ka një qasje politike, domethënë ju keni përmendur se një prej konditave për t'u rizgjedhur do të duhet të jetë kryerja e kësaj shkolle. Domethënë, sistemi aktual i drejtimit mbi bazën e përzgjedhjes politike, mbi bazën e këtij kushti që ju keni vendosur, nënkupton se ky sistem aktual është i privilegjuar në raport me të gjithë të tjerët. Kjo duhet të shmanget.

Unë flas si specialist i arsimit. Kam 32 vjet në sistem. Kam punuar në sistemin parauniversitar dhe 30 vjet në sistem, ndaj kërkoj me përgjegjësi, që një gjë e tillë të mos ndodhë, pra duhet të eliminohet. Kërkoj edhe përgjegjshmërinë tuaj, të nderuar kolegë, se kjo gjë nuk duhet të ndodhë fare.

Për sa i përket pikës 4, neni 29, Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, mbi çfarë kriteresh është bërë përzgjedhja e anëtarësisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem! Unë kam qenë anëtar i Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës, dhe në këtë institucion kanë marrë pjesë specialistët më të mirë të arsimit, në periudhën 2005 – 2013, 2014.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ilir, mos ndërhyj, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull! E drejtë! Këtu jam dakord me ju!

E kam fjalën këtu: janë përzgjedhur jo mbi bazën e kriterëve politike, por mbi bazën e kontributit që kanë dhënë në arsim, ndaj unë kërkoj që këtë gjë ta respektoni edhe ju, nga ana juaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Neni 11, pika 2 dhe pika 4 e nenit 48, në lidhje me dispozitat normative për trajtimin e fëmijëve që lëvizin për shkak të emigracionit. Do të duhet t'i rregulloni dispozitat normative të fëmijëve që vijnë nga emigracioni, për shkak se krijohen probleme, sidomos në pjesën e provimeve fundore të shkollës, me testet. Duhet ta rregulloni këtë.

Shkojmë te neni 14. Keni në drejtim, emëruar me komandim drejtorë, të cilët nuk e kanë ushtruar për një periudhë të gjatë ose nuk e kanë ushtruar asnjëherë profesionin e mësuesit, por kanë marrë, le të themi, bekimin e drejtorive rajonale, ndoshta edhe bekimin tuaj, për të qenë në drejtim. Janë aktivistë e militantë të Partisë Socialiste edhe sot.

Praktikisht, certifikatën e kanë marrë vetëm militantët. Kjo gjë do të duhet të eliminohet, sepse në nenin 14 thuhet: “mësues i kualifikuar” dhe do të duhet të jetë i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar, gjë që ka ndodhur konkretisht, *de facto*, me atë shkollën e famshme gjashtëmujore, që nuk duhet të ndodhë.

Tani të dalim te gjëja që e kemi diskutuar disa herë, zonja Ministre. Unë po ju paraqes kërkesat e mësuesve të ciklit të ulët, të cilët janë shkolluar në fakultetet e Shkodrës, Elbasanit, me cikël të mbyllur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Aty mund ta keni zgjidhur, e di që e keni zgjidhur, po, po, e di, po përsëri në ligj e keni lënë evazive dhe i konsideroni sërish *bachelor*. Do të duhet ta rregulloni këtë pjesë, sepse e kemi diskutuar edhe me Ismetin, kemi rënë dakord, edhe me kolegët e tjerë kemi rënë dakord, që kjo do të duhet të jetë precise në sistem.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mësuesit, të cilët deri në vitin 2004 kanë kryer ciklin e ulët, pavarësisht se ka qenë trevjeçar, zonja Ministre. Ashtu ka qenë shkolla, nuk është faji i tyre. Duhet ta konsiderojnë jo *bachelor*, por cikël i mbyllur shkollor. Kjo është një kërkesë, që unë jua kam përcjellë. Në fakt e keni zgjidhur përkohësisht, vetëm për mësuesit në sistem, jo për mësuesit e rinj, që mund të futen

në portal dhe kanë kryer të njëjtën shkollë. Kjo do të duhet të sistemohet, sepse është shumë e rëndësishme.

Neni 17. Keni përjashtuar nga mundësia e certifikimit e të licencimit studentët që kanë kryer masterin shkencor. Domethënë, do të duhet t'i inkludoni në këtë sistem. Domethënë, kanë kryer masterin shkencor në matematikë, fizikë. Ata nuk kanë nevojë për formim ekstra, sa t'i përjashtoni nga sistemi i rekrutimit në sistemin arsimor.

Posaçërisht, e kam për ju, zonja zëvendësministre, sepse problemi kryesor që mbetet në sistemin tonë është formimi i mësuesve të matematikës e të fizikës. Prej shumë dekadash nuk ka një trajtim të veçantë. Para dy muajsh, në mos gabohem, ju keni bërë një zgjidhje pozitive në trajtimin e studentëve, por do të duhet të sanksionohet krejt mirë, sepse themelore në formimin e nxënësve shqiptarë janë matematika dhe fizika, të cilat fatkeqësisht, në kurrikulat shkollore parauniversitare kanë rënë në formim. Domethënë, unë kërkoj të bëni ndryshimet adekuate, duke marrë si model në shkencat natyrore modelin e fundit të viteve '80, i cili ka qenë më i përparuari, dhe nxënësit që kanë kryer shkencat natyrore në këtë periudhë, domethënë në shkollën e mesme, kanë bërë ato programe, kanë pasur aftësi të shkonin në çdo universitet të Perëndimit.

Kjo gjë do të duhet të korrigjohet. Nuk do të ulet ngarkesa, në këtë pikë është shumë e rëndësishme. Këtu ka një prapësim, të cilin ndjej për detyrë t'ju them. Nuk është hera e parë që e them, e them prej disa vitesh, e kam thënë edhe në shtypin shqiptar, por dua ta përsëris, që të gjejmë mënyrën për ta ndalur këtë sistem.

Në fund fare, dua të flas për pjesën e ndryshimit të institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit. Unë jua thashë edhe më parë: e konsideroj të papërshtatshme që, një “ëndërr e një nate vere” të sillet në një çmontim të institucioneve, të cilët janë konsoliduar prej dekadash në këtë vend. Ju nuk duhet ta prishni atë sistem të institucioneve të varësisë, të cilat janë konsoliduar prej dekadash, për shkak të ekspertizës, për shkak të rëndësisë e për shkak të çorganizimit. Ta dini mirë, ju po bëni një çmontim të caktuar, me një kosto të caktuar, në një vend të varfër, por do të vijë një moment, kur dikush tjetër në qeveri, do të bëjë një ndryshim për ta rikthyer mbrapa, dhe kostot e kësaj ëndrre të dikujt, në kuadrin e proceseve të caktuara, të cilave nuk dua t'u vë një emër, pra do të ketë një kosto për publikun shqiptar, një kosto për arsimin shqiptar, një kosto për mësuesit, për cilësinë.

Unë do t'ju lutesha, zonja Ministre, që ato ndryshime që keni ndërmend të bëni, t'i ndaloni, duke ruajtur kështu strukturën aktuale të institucioneve të varësisë së sistemit tuaj të ekspertizës e të kontrollit.

Ju faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Unë do t'ju lutesha shumë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për diplomat e kishe?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do t'ju lutesha shumë: kushdo që merr fjalën tani, sepse kemi shumë orë që flasim, t'i përmbledhë, të mos përsëriten pyetjet dhe çështjet e njëri - tjetrit. Është diskutim në...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E ka nënkryetarja.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem! E ka nënkryetarja, për procedurë. E keni përfaqësuese.

Do t'ju lutesha shumë, që të mos përsërisim njëri-tjetrin, sepse ende nuk i kemi dhënë mundësinë ministres, që të fillojë t'u përgjigjet pyetjeve.

Milva Ekonomi – Unë do të flas për procedurë. Jemi tre vetë që kemi ngelur pa bërë pyetje: unë, zonja Adelina dhe zoti Bujar. I tërheqim tre pyetjet, sepse ndërkohë i janë bërë aq shumë pyetje ministres, sa s'ka më kohë për të bërë pyetje të tjera. Mbase do të kënaqemi me përgjigjet që do të na japë zonja ministre dhe nuk ka nevojë të bëjmë pyetje.

Albana Vokshi – Ne kemi vetëm Luçianon dhe do ta mbyllim. Pastaj do të ketë përgjigje dhe diskutimi i grupeve.

Zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë do të përqendrohem vetëm në një pikë të caktuar të ndryshimeve ligjore që sillen në këtë komision. Dua të vazhdoj fjalën e kolegut tim Ismetit, i cili evidentoi një fakt.

Janë bërë ndërhyrje ligjore të vazhdueshme në ligjin “Për arsimin parauniversitar”, gjatë këtyre viteve të qeverisjes së majtë, dhe kanë konsistuar vetëm në ato nene që prekin emërimin, çëmërimin e mësuesit, jo pozitën dhe dinjitetin e mësuesit. Në projektligjet, në iniciativat që ka sjellë ministria, nuk bëhet fjalë as për përmirësimin e pozitës së mësuesit, as për rritjen e pagës së

tij, as për përmirësimin e infrastrukturës shkollore, as për cilësinë e edukimit, ndërkohë vërejtjet reale të sjella nga deputetët parafolës këtu, janë shqetësime që vijnë nga prindërit, qoftë testi që u përmend, i cili ishte një test i papranueshëm nga prindërit e për moshën së cilës i drejtohej, sikurse dhe ndërhyrja e grupeve të LGBT-së në shkolla, për të promovuar disa gjëra që shoqëria jonë i konsideron antivlera. Është tjetër gjë respekti për diferentimin, të ndryshmin, tjetër gjë është imponimi dhe promovimi i gjërave të tilla në ambientet e shkollës, ku sipas ligjit “Për arsimin parauniversitar” nuk lejohet askush dhe nuk lejon askënd të ndërhyjë në ambientet shkollore për të avancuar edukimin, që është pjesë e programit kombëtar të arsimit. Pra, është vepruar në kundërshtim me këtë ligj.

Sigurisht, duke pasur në fokus politizimin e arsimit, ju deri më tani e keni arritur këtë me format tuaja. Unë kam vërejtjet e mia në lidhje me mënyrën se si ka vepruar portali. Është ligjor, deri më tani, ju po e bëni ligjor; sigurisht, mund të thoni: “e provuam, ka udhëzim”. Por, sipas parimit kushtetues, udhëzimet dalin në përputhje me ligjin në fuqi. Kështu, i bie që udhëzimi ka kundërshtuar ligjin, sepse nuk është përputhur me ligjin, në lidhje me portalin. Sot ju përpiqeni ta përputhni dhe ta bëni pjesë të ligjit. Po ashtu, kam vërejtjet e mia për inspektoriatin, që bashkohet me IZHA-n, një institucion që është ekzekutiv, me një institucion kontrollues, që për më tepër duhet të ketë pavarësi, e për më tepër ju i referoheni një sistemi, të cilit i keni marrë tekstet, por nuk i merrni strukturën, pasi inspektoriatin në Mbretërinë e Bashkuar është autonom dhe ka varësi të drejtpërdrejtë nga hierarkia më të larta, përpos Ministrisë së Arsimit.

Në fakt, shqetësimi im lidhet pikërisht me pozitën e mësuesit, pasi pagat nuk rriten, buxheti për arsimin nuk rritet, ndryshimet ligjore vetëm e kanë goditur dhe e godasin figurën e mësuesit.

Dua të sjell këtu vetëm një shembull të thjeshtë, sepse dua të transmetohet nga ju e të zgjidhet, pasi në një zonë të caktuar, nëse doni e përmend, është zona e Librazhdit, mësuesve u është refuzuar pagesa e transportit. Të mjerët kanë bërë një ankimim në portalin e famshëm të bashkëqeverisjes. Aty është pranuar që transporti i mësuesve nuk është paguar vetëm për një periudhë të përcaktuar pas shkurtit, për një arsye krejtësisht banale. Arsyeja është që drejtoria arsimore, Ministria e Arsimit ka humbur gjyqet për përjashtimin e mësuesve nga puna. Kësisoj, meqenëse ka humbur gjyqet, përmbarimi ka bllokuar llogarinë e pagave, ndërkohë që fondi që jepet për transportin, nuk është pjesë e fondit të llogarisë së pagave. Është përgjigjja e portalit dhe është pranuar nga vetë ju.

Është denigruar mësuesi, nuk paguhet, nuk i jepet paga e trembëdhjetë; merret kur doni ju, si doni ju edhe nga pushimet që ia përcakton kontrata. Deri në këtë fazë e keni çuar figurën e tij, e keni denigruar, duke ia hequr edhe këtë lloj të drejte që ia njih ligji.

Ky është vetëm një rast i thjeshtë, i cili prapëseprapë flet shumë, pasi mund të sjellim këtu me qindra raste të tjera, por koha nuk është në dispozicion. Sigurisht, jemi duke diskutuar edhe çështje ligjore.

Pjesa ku doja të përqendrohesha është pikërisht ajo që u bë pjesë e debatit, pjesë e diskutimeve edhe nga kolegët e tjerë. Është çështja e shkollës së drejtorëve. Në fakt, shkolla e drejtorëve është një avancim i idesë suaj, për të kapur politikisht drejtimin e arsimit, pavarësisht se në retorikë politike e bla – bla – bla: “jo, të mos jetë anëtar i forumeve”, tha Luani. E lini evaziv forumin, se forum partia është. Përgjatë gjithë kësaj kohe pesëvjeçare, ju jeni me një akuzë të vërtetë e reale. Pjesa më e madhe e drejtorëve janë të komanduar politikisht nga drejtoritë arsimore. Pjesa më e madhe e nëndrejtorëve janë totalisht politikë dhe procedura e mbajtjes së tyre në punë ka qenë në kundërshtim me ligjin, pasi me ligjin “Për nëpunësin civil”, një i komanduar nuk mund të qëndrojë në detyrë më shumë se gjashtë muaj. Edhe kur keni bërë konkurse formale, keni emëruar po të njëjtët njerëz.

Pra, sot ne flasim për një shkollë drejtorësh në një terren të mbushur me drejtorë politikë. Nuk e di ku do të arrini me shkollën e drejtorëve, por me sa duket doni të evidentoni armiq të tjerë politikë, t’i lëvizni edhe ata e t’i zëvendësoni me këta të tjerët, të cilët do të dalin nga shkolla juaj politike e drejtorëve.

Duke iu referuar asaj fasadës, të cilën e përdorni shpesh, që Mbretërinë e Bashkuar e keni yll polar, ju e dini shumë mirë, se është relacioni, jua kam përmendur disa herë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ministre, po pra, mos ma bëj dorën ashtu! Unë s’kam qejf të bëj batuta të pakëndshme, por edhe ato janë pjesë e politikës, kështu që mos më ngacmo! Unë kështu flas.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, por s’duhet të thotë ministrja “ule dorën”, tani!

Ilir, s’mund të më thotë mua ministrja...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ilir, e ngre dhe e ul vetë nivelin unë. Të dëgjojë argumentin e të mos më thotë mua “ul dorën, ul kokën”!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani, të jetë më korrekte.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, të lutem! Shumë deficiente në komunikim.

Pjesa tjetër është ajo...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në komunikim, me mungesa.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Deficiente, me mungesa në komunikim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

More, e kuptoni gjuhën ju apo s'e kuptoni?! S'doni ta kuptoni gjuhën ju?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me mungesa. Përdora një fjalë. Ç'është kështu? Nuk doja ta ofendoja fare, në mënyrë absolute!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në komunikim, pra, në komunikim. Për komunikimin e kam. Po, është deficiencë në komunikim. Mungesë në komunikim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Keni Mbretërinë e Bashkuar yll polar. Atje, te relacioni juaj, që keni dërguar grupin e punës, keni përcaktuar se drejtuesit në Mbretërinë e Bashkuar mund të ndjekin një shkollë drejtorësh, por nuk mund të emërohen në bazën e kësaj shkolle, është opcionale. Shkolla e drejtorëve në Mbretërinë e Bashkuar është njëvjeçare dhe jo gjashtëmujore. Gjashtëmujor mund të jetë kurs, jo shkollë.

Duke ballafaquar pikërisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord! Ja, do ta argumentoj, se keni përcaktuar afatin gjashtëmujor. Në rregull, tërhiqem, se kjo është pjesë e krediteve, e punës, e praktikës, kjo është çështje modaliteti. Do ta diskutojmë kur të dalë struktura dhe mënyra e organizimit të shkollës së drejtorëve.

Në këtë rast, për hir të kësaj gjëje të pasqaruar, dhe unë po e tërheq atë pjesën e akuzës gjashtëmujore. Nuk do të pretendoja të ishte gjashtëmujore, por do të thosha: pse kjo shkollë vjen në këto momente kur, siç thashë, e keni mbushur arsimin me drejtorë politikë?

Gjatë kohës që ju flisnit, zonja Ministre, në fakt edhe Albana e tha, erdhën shumë mesazhe. Në fakt, nuk dua të përmend emra, se ata që janë drejtorë kanë edhe marrëdhënie personale, por duhet të na kuptojnë se këtu jemi në politikë. Nga Kruma më kanë ardhur emra konkretë, janë drejtorë tërësisht politikë: Selman Çema, thotë ai. I pashkollë, shkruhet për të, por duhet të jetë pa arsim përkatës. Kryetari i PS-së për qytetin e Krumës është drejtor; Flamur Dauti, anëtar i PS-së, është drejtor; Besim Dani, anëtar i PS-së, është nëndrejtor gjimnazi; Mirela Lleshi, e paarsimuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bujar, të lutem, e kam me fakte.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, po, kanë gënjyer. Bujar, ti je nga Lushnja, ata nga Kruma, dhe e ballafaqove ti të vërtetën!

Mirela Lleshi, anëtare e PS-së, edhe kjo drejtoreshë.

Kamzën e ke të kuqe komplet, me drejtorë. Mund t'i lexoj, duke nisur nga drejtoresha e Drejtorisë Arsimore, e cila ka qenë shumë aktive në fushatat e Partisë Socialiste dhe e kemi denoncuar. Po ashtu edhe drejtorët e tjerë. Sikurse ta përmendi edhe Romeo, Puka është shembulli më i ndritur. Të gjithë drejtorët e shkollës...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prandaj them unë se ke deficienca në komunikim. Prandaj ta them, kjo është arsyeja.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ju lutem, mos ndërhyini! Të mbarojë, e pastaj jua japim fjalën...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Thuaji të mos më ndërpresë. Është shumë e thjeshtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja edhe shqetësimi i Romeos për çështjen e Pukës, ku drejtorët e shkollave marrin pjesë në të gjitha aktivitetet politike të Partisë Socialiste. Janë të dërguara me foto, i kemi me foto dhe do t'i denoncojmë.

Pra, kjo është ajo shkolla e drejtorëve.

Dalim te procedura e krijimit të kësaj shkolle drejtorësh, sepse jua thanë edhe këtu. Romeo bëri një lapsus. Tha: është bërë shkolla. Po, është shkolla e lidërsipit në arsim. Projekti pilot ishte marrëdhënia që ju do të ndërtonit me fakultetet e mësuesisë. Në lidhje me këtë, ne kemi kërkuar që mësuesi të trajnohet si profesionist pikërisht në fakultetet e mësuesisë, sepse aty ngjizet mësuesia, aty është edhe pedagogjia.

Meqenëse u ngacmova nga fjala e Ismetit, është vendimi për mesataren 7, se s'kemi pasur rast. Mësues nuk quhet studenti që vazhdon *bachelor* Histori - Gjeografi, Biologji – Kimi, Matematikë – Fizikë, por mësues është ai që merr masterin profesional, jo shkencorin, dhe kërkon të drejtohet drejt arsimit. Këtu duhet të ndërhyjë mesatarja, që të zgjedhim cilësisht më të mirët dhe t'i financojmë. Ajo pjesa e ndërhyrjes do t'i zbrazë këto degë, të cilat nuk do të jenë më as degë të detyruara e as të kërkuara. Do t'i braktisin. Kjo është frika ime, në këtë rast. Po, na duhet një mësues i përgatitur, për të vënë kritere, por në kohën e duhur. Në momentin që ai merr masterin, duke u orientuar nga fakulteti, se nuk është kompetencë e ministrisë.

Pjesa e trajnimit, më pas, vazhdoi me shkollën, e cila pretendohet se do të përgatiste drejtuesit. Unë i kam këtu të gjitha deklaratat tuaja. Madje keni marrë pjesë edhe në hapjen dhe inaugurimin e saj, keni mbajtur dhe fjalën. Sipas ish-këshilltarit tuaj, në fakt jo këshilltarit, se ky ishte lapsusi që bëri Romeo, ju do të përgatisni për gjashtë vjet rresht të gjithë mësuesit. Në 2016-ën është bërë deklarata, sipas të cilës janë përgatitur 260 drejtorë, punë që ka vazhduar, dhe sipas jush, këta drejtorë që u komanduan, mbaruan shkollën e lidërsipit të arsimit, sot janë drejtues të certifikuar të drejtimit të shkollave në të gjithë Shqipërinë. Pra, janë tërësisht politikë.

Ndërkohë unë kam shqetësimin: kjo shkolla e lidërsipit të arsimit, meqenëse nuk ishte e parashikuar në ligj, ku e gjeti bazën ligjore që të ngrihej? Po, në një pjesë të saj është bërë në mbështetje nga UNICEF-i, por a vazhdon mbështetja e UNICEF-it? Patjetër ne duhet të kemi një bazë ligjore për të ngritur një institucion të tillë. Certifikata që u është dhënë atyre është aligjore, sepse nuk është shkolla që i thatë Romeos. Çfarë shkolle drejtorësh!? Ne nuk kemi. Ata kanë marrë certifikatën, që janë drejtorë të certifikuar e të kualifikuar.

Prandaj duhet një sqarim i qartë ligjor: mbi bazën e cilit ligj është ngritur certifikimi ligjor i këtyre drejtorëve? Kjo certifikatë ligjore, me ngritjen e shkollës paralele, e zhvlerëson certifikatën e dalë nga lidërsipi i arsimit? Sepse është shumë e thjeshtë. Sa certifikata keni nxjerrë? Një herë në bashkëpunim me fakultetet, një herë lidërsipi i arsimit, ndërsa tani do të nxirrni certifikatën me drejtoritë e shkollave! Ndajeni se cila është e vlefshme.

Po vazhdoj pjesën e pyetjes. Pyetje u bënë shumë. Nuk kam ndërmend të bëj shumë pyetje, se nuk kam marrë ndonjëherë përgjigje të saktë, meqenëse grumbullohen në fund, një pjesë e madhe anashkalohen, një pjesë harrohen, një pjesë grumbullohen. Thjesht po përcjell atë shqetësimin, që u tha këtu në forma të ndryshme.

Me drejtorët politikë aktualë, që janë emëruar në gjithë Shqipërinë, si do të veprohet në momentin që hyn ligji në fuqi? Sepse ligji e përcakton që s'duhet të jetë anëtar i asnjë partie politike!

Ky është shqetësimi kryesor. Do t'i shkarkoni në grup apo do t'u thoni të heqin dorë nga taserat e partisë. Një zgjidhje duhet, sepse ligji hyn në fuqi menjëherë. Hyn pas miratimit, kuptohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Illir, je shumë i bezdisur, o burrë! Unë po flas për një çështje të rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti e ke mendjen te gjëra të tjera tani, te lista e rimbursimeve. Ne po flasim për listë drejtorësh.

Kjo është pyetja. Nuk dua t'ju ngarkoj me shumë pyetje, sepse i bënë kolegët e mi. Nuk dua as t'i përsëris ata e as t'ju vë në pozitë të vështirë në lidhje me përgjigjet.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Para se t'jua kaloj fjalën, që t'u përgjigjeni pyetjeve, të cilat besoj se mund edhe t'i gruponi, sepse një pjesë e pyetjeve kanë qenë të ngjashme, unë kam vetëm një pyetje në lidhje me VKM-në e fundit, që ju keni nxjerrë për tekstet falas. Nuk është kuptuar shumë mirë nëse këto tekste do të jepen në përdorim apo do të jepen falas? Si e keni menduar këtë çështje? Sa vite do të jepen? Do të duhet t'i kthejnë pas? Nëse nuk i kthejnë, do të duhet të paguhen? Pra, a mundet që ta bëjmë pak të qartë edhe këtë pjesën e teksteve falas, sepse ka shumë paqartësi? Ne e kemi të paqartë si skemë. Nëse është falas, dakord, por nëse është në përdorim, është tjetër fjalë. Unë e kam krejt të paqartë këtë pjesë: është në përdorim apo i jepet falas dhe nëse nuk e kthejnë, cili është penalteti për prindërit apo për fëmijët?

Lindita Nikolli – Faleminderit për të gjitha pyetjet, të cilave do t'u përgjigjem me seriozitetin më maksimal!

Nuk e di ku i keni parë, profesor, të rinjtë dhe të rejat e FRSH-it, korridoreve të ministrisë, sepse në Ministrinë e Arsimit punësohesh përmes DAP-it.

Nuk e di se kujt i referoheni kur thoni për rikonstrukcion godinash dhe jo shkollash, se është një gjë a pavërtetë, të paktën, nëse i referohemi buxhetit të këtij viti.

Iu referove rastit të një mësuesi në Kamëz. Unë do t'ju sqaroj se si është historia e atij mësuesi dhe një gjë dua të theksoj se nuk ka lidhje fare politika.

Urim Halili më ka takuar dhe aludon se është simpatizant i flaktë i PS-së, por kjo nuk zhbën arsyet se pse ai është larguar nga puna, të cilat unë mund t'i sqaroj privatisht.

Pyetjes tjetër të zonjës, që “pse jeni kaq e papërgjegjshme”, mund t'i përgjigjem se sigurisht një e përgjegjshme nuk mund të japë arsyet për atë që nuk është, ashtu sikur nuk do të prisja përgjigje nga ju për pyetjen se si flitet me etikë. Nuk mund ta dish, se nuk e ke.

Iu referove çështjeve të dëftesave. Pse gabim?E përsëris edhe një herë se nuk ka asnjë dëftesë të plotësuar gabim për nxënësit. Ishte vetëm një gabim që u tejkalua, se dëftesat që shkojnë në shkollë janë dëftesa që nuk kanë asnjë gabim...

Albana Vokshi – Domethënë ato që u tërhoqën ishin me gabime, kjo është ajo që po thoni...

Lindita Nikolla – Po, e bëra publikisht, se e falënderova Luçiano Boçin...

Albana Vokshi – Njëherë thatë se e kishte sajuar opozita, të paktën të jenë të qartë...

Lindita Nikolli – Nuk thashë fare ashtu...

Albana Vokshi – Domethënë ju po pranoni se 40 mijë dëftesa ishin gabim?

Po çfarë rëndësie ka 1/10?! Edhe 2 nxënës, edhe 2 dëftesa të ishin gabim, kush mban përgjegjësi? Sa është kostoja?

(Diskutime pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – 1 milionë lekë të vjetra... mban përgjegjësi grupi i punës dhe unë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Do t'i dëmshpërblejmë një nga një, se kemi përgjegjësi ne, jemi ndryshe. Nuk e kupton dot. 1 milionë lekë të vjetra...

Firma brenda dy ditësh korrigjoi dëftesën e klasës së 9-të, se kishte bërë një kapërcim gjatë shtypit, nga 9-ta kishte shkuar te 11-ta...

Albana Vokshi – Po ju çfarë bënit? Ishit me pushime?

Lindita Nikolla – Zonjë, me pushime duhet të ishit ju, se keni marrë edhe ngjyrë, kurse unë jam në krye të detyrës.

Albana Vokshi – Po çfarë budallallëqesh flet, edhe minister!... Shyqyr që e pranuat se keni përgjegjësi personale për 40 mijë dëftesat...

(Diskutime pa mikrofon.)

Lindita Nikolli – Patjetër që e pranoj, se nuk fshihem pas gishtit unë, por gishtin e drejtoj nga vetja.

Portali “Mësues për Shqipërinë” dhe shkolla e drejtorëve.

Të nderuar deputetë,

Duke e kuptuar edhe politikën, edhe njerzillëkun, vij në atë gjendje kur njerzillëku dhe politika na qenkëshin të ndara. Po ju them se me ligjin që kishim, a mund t’i emëroja drejtorët politikë jashtë profilit, mësuesit politikë jashtë profilit, me zarfet e korrupsionit, me ndërhyrjet e deputetëve, me ndërhyrjet e kryetarëve? A e bëja? Kush më pengonte? Askush.

Portali “Mësues për Shqipërinë” erdhi pikërisht për të ndaluar këtë proces dhe besojeni fort këtë gjë. Ka pasur edhe problematika, sigurisht, por ne kemi përsosur si testim, ashtu edhe forcimin, duke e vendosur në ligj, që askush të mos guxojë, duke pretenduar se shkel një udhëzim ministri, por ta dinë se është në shkelje të rëndë të ligjit.

Ata që nga i dyti kanë shkuar tek i gjashti, po ikin çdo ditë nga puna dhe ju referoni rastet që ka qenë radha e të dytit. Ka raste edhe kur refuzon i dyti, se mund të jetë një vend pune në fshat dhe sigurisht do të merret i treti, por ama lihet gjurmë. Sistemi tani nuk ka më komision, është gjithçka digjitale. Pra, nëse del një vend pune në shkollën x, mësuesi i parë i asaj lënde, në atë qark, njoftohet dhe nëse është gati, i printohet fleta, paraqitet para drejtorit të shkollës dhe fillon detyrën.

Kjo është e vërteta e portalit për atë që duam të bëjmë, të largojmë politikën dhe korrupsionin, që ligji nuk e ndalonte.

E njëjta gjë me shkollën e drejtorëve. Unë jam e para që ju them dhe jam me zë dhe me figurë para prindërve shqiptarë...

(Diskutime pa mikrofon.)

... KLSH-ja, lexoje e dashur, bëhet fjalë për portalin e maturantëve “iAlbania”, nuk bëhet fjalë për portalin e mësuesve.

Tjetra që dua të them është se shkolla e drejtorëve është një risi. Ne e pilotuam për të parë se sa dhe si kjo sjell progres. Lavdi Zotit, kemi një institucion kredibël që na sjell në mbështetje ekspertizën më të mirë ndërkombëtare, siç është Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, i cili ka

financuar 2,9 milionë dollarë për të pasur një shkollë ekselence, ku do të mësohen drejtorët e së ardhmes...

Albana Vokshi – Mbi bazën e cilit model e bëni këtë?

Lindita Nikolla – Amerikan, europian... Kur të vijnë nen për nen, do t'i themi edhe të gjithë modelet ...

Albana Vokshi – Keni marrë modelin anglo-sakson për shkollat dhe ju merrni model amerikan për shkollën e drejtorëve. Është nonsens. Anglia e ka ndryshe. Skocia e ka ndryshe. Të gjitha vendet e BE-së e kanë ndryshe. Më thoni një model?

Lindita Nikolla – Nuk ju pëlqen Amerika? Ke probleme me Amerikën?

Albana Vokshi – Aman, të lutem! Nuk të shkon fare kjo! Mos e bëj bajat fare!...

Ke marrë model anglo-sakson. Ku e merr këtë modelin e kësaj shkolle, se nuk ekziston ky model?

Lindita Nikolla – Nuk është modeli i shkollës, moj zonjë, po modeli i trajnimit të menaxherëve të shkollës...

Albana Vokshi – E ke quajtur “shkolla e drejtorëve” dhe unë po i referohem kësaj... çfarë bëjnë 216 që i ke certifikuar? Ku shkojnë ata? Po nuk e vazhdon atë të këshilltarit?...

(Diskutime pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Në krye të shkollave janë drejtorët më të mirë ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Na thoni ku jeni mbështetur? Nuk ka asnjë shtet që i jeni referuar, që keni marrë eksperiencë. Si vjen relacioni pa pasur një gjë konkrete? Vetëm ju dini t'i bëni këto...

(Diskutime pa mikrofon.)

Lindita Nikolla – Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim na u bashkëngjit në një nismë shumë të vyer për sistemin tonë arsimor. Nuk e ndërrojmë modelin e shkollës shqiptare, as sistemin arsimor, por sjellim në krye të shkollës shqiptare persona të mirëtrajnuar dhe të certifikuar për detyrat që janë mirëfilli menaxhim, administrim dhe projekte shkollore. Kaq e thjeshtë është.

Nëse i referoheni sërish politikës, nëse i referoheni edhe korrupsionit, ligji që kemi e lejon të bëhet e mundur kjo gjë. Përkundrazi, kjo që po ndryshojmë, e pengon edhe politikën, edhe korrupsionin...

Albana Vokshi – Po ku pyesni ju për ligj? Ju po shkelni Kushtetutën!..

(Diskutime pa mikrofon.)

Portalin e ke antiligjor, shkollën e ke antiligjore, të gjitha nismat i ke antiligjore, tekstet falas i ke antiligjore, çdo gjë e ke antiligjore. Tani po mundohesh të vësh diçka në ligj dhe këtë e ke gabim.

Lindita Nikolla – Pyetët për mësuesit jashtë profilit dhe si do të jenë pas rregullimit që po i bëjmë ligjit.

Profesoreshë Vali e sqaroi, bëhet fjalë për gjithë ata studentë që kanë mbaruar master shkencor në matematikë, fizikë, histori, gjeografi, programe të tjera, që ligji nuk jua lejon të marrin licencën e mësuesit, për shkak se nuk kanë kreditet e caktuara në pedagogji dhe psikologji.

Ne do t'u japim mundësi fakulteteve të edukimit, pra universiteteve tona që të mundësojnë këto kredite për ata që shprehin dëshirën t'i marrin dhe më pas të licencohen për të hyrë në sistem. Në bindjen time më të thellë janë studentët që e meritojnë më shumë për të qenë pjesë e sistemit arsimor.

A do e bëj unë në Lezhë apo në Shkodër? Jo, nuk bëhet në Lezhë. Se ku bëhet, nuk e di, por në Lezhë nuk bëhet.

Do të ketë 61 zyra të shërbimit arsimor në çdo bashki dhe do të ketë 4 drejtori rajonale të sigurimit të cilësisë për rajonin.

Ju kishit shqetësimin që unë do të abuzoja, nga fakti që jam deputete atje. Unë po të them “jo”. Rri i qetë, se nuk abuzoj, megjithëse nuk është abuzim!

Pse ju abuzoni që e kërkon në Shkodër?

Në qoftë se ju abuzoni se e kërkon në Shkodër, atëherë abuzoj edhe unë që e çoj në Lezhë.

Romeo Gurakuqi – Unë solla argumente të mjaftueshme që ajo duhet të qëndrojë në Shkodër, ashtu sikurse duhet të qëndrojë në Vlorë, në Korçë dhe në Tiranë ose në Durrës.

Lindita Nikolla – Pyetët për 12 gjimnaze dhe 1 universitet publik. Janë më shumë se 12 gjimnaze, të cilët janë gjimnaze shumë të mirë. Edhe Shkodra nuk ka vetëm “28 Nëntorin”, por ka edhe gjimnaze të tjera të arsimit publik dhe privat që janë gjimnaze shumë të mira dhe performojnë shumë mirë në atë që vlerësohen përmes kartës së performancës dhe maturës, megjithatë ne ende nuk kemi një rankim cilësor për të gjitha institucionet tona të arsimit parauniversitar.

Struktura e re, mundësia që ne do të japim për të pasur inspektorë që monitorojnë standardet e cilësisë në mënyrë permanente, serioze dhe transparente do të bëjë të mundur që ne të masim dhe t'i bëjmë publike në të gjithë vendin rankimin e shkollave.

Për çështjen e universiteteve e kam të pamundur të them se si mund të krijojë Ministria e Arsimit një universitet publik ekselent. Ky është një ndërveprim, sigurisht është tagër i universiteteve. Ato janë entitete autonome, veprojnë në pavarësinë e tyre dhe kanë lirinë akademike. Besoj që vullneti i profesoratit tonë të nderuar do të jetë që ne të kemi universitete në ato standarde që ju thoni, megjithatë edhe sot që ne flasim ka universitete që performojnë mirë dhe po ecin drejt atij trendi.

Çështjet e lëvizjeve paralele nuk zhvillohen pa ndërhyrjen e deputetëve socialistë, thoni ju.

Për lëvizjen paralele sërish është portali “Mësues për Shqipërinë”, pra, nëse unë jam një mësuese në Tiranë dhe dua të shkoj në Durrës, duhet të matem me punëkërkuessit e Durrësit në atë profil, pa humbur vendin tim të punës, dhe nëse unë rankohem përpara tyre, kur të më vijë radha, bëhet edhe transferimi, që të jemi në kushtet e barazisë.

Ju thoni se portali nuk është transparent. Po ju them se portali është transparent. Me ndërhyrjet që kemi bërë në sistem në mënyrë elektronike është transparent. Ai tregon deri ku ka shkuar lëvizja, cilat janë vendet e lira të punës, sa ka qenë rankimi, ndryshe nga portali që kishim më parë, i cili thjesht evidentonte në sportele apo në vende të dukshme në Drejtorinë Arsimore.

Këto shifra marramendëse që u japin njerëzve pa shkollë, nuk e di se kujt i referoheni.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nuk janë para të buxhetit, por janë para të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit, i cili investon për Shqipërinë, për shkollën e drejtorëve. Besoj se ky nuk është institucion pa ekspertizë dhe jokredibël.

(Diskutime pa mikrofon.)

Çështja tjetër që lidhet me faktin se drejtuesit e shkollave nuk duhet të jenë pjesë e forumeve.

Sigurisht, ligji këtë e ndalon. Mbetet në diskrecion të të gjitha agjencive që zbatojnë ligjin, por edhe në zgjedhjen personale të njerëzve, të cilët do të zgjedhin të largohen nga detyra apo të mbajnë pozicionin politik.

Këshilli i prindërve. Ne kemi bordet dhe këshillat e prindërve në çdo shkollë. Në bazë rajoni është zgjedhur Këshilli i Prindërve të Rajonit. Çdo këshill prindërisht në rajon zgjedh një përfaqësues në Këshillin Kombëtar të Prindërve dhe ky këshill përmes votës zgjedh kryetarin e vet.

Kjo është procedura që është ndjekur.

(Diskutime pa mikrofon.)

... në ligj nuk shkruhen të gjitha...

Vullneti ka qenë për të sjellë prindër profesionistë dhe njerëz që monitorojnë dhe dinë të ndërtojnë ekspertizë.

Për sa u përket mësuesve ndihmës, është e vertetë që u kanë munguar universiteteve programet në pedagogjinë speciale. Ka pasur vetëm Vlora dhe ka mungesa për të pasur mësues ndihmës profesionistë, të formuar nga universitetet. Me kërkesë për çeljen e programeve ka filluar Korça dhe Elbasani, të cilat besoj se e përmbushin misionin që ne kemi për të mësuar për çdo fëmijë me aftësi të kufizuar, ekspertizën e mësuesit ndihmës.

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nuk iu përgjigj asnjërës prej pyetjeve. Për shembull, pyetjes sime për Shkollën e Drejtorëve nuk iu përgjigj.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ministre që nuk di se çfarë shkruan në relacion...

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë e pyes për modelin, ajo thotë amerikan, ndërsa në relacion thuhet se modeli i kësaj shkolle është i vendeve të BE-së. E kuptoni tani?

(Diskutime pa mikrofon.)

Faqja 3, paragrafi ...

E ke të shkruar këtu. Ministre që nuk di se çfarë shkruan në relacion, mua vetëm këtë më kanë zënë sytë!...

Po ngatërroi fondacionin me modelin. Nuk kemi asgjë me fondacionin ne...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ku e keni marrë modelin për Inspektoratin që e keni hequr, zonja Ministre?

Lindita Nikolli – Edhe një herë, është model amerikan dhe i vendeve të BE-së për sa i takon shkollës së drejtorëve.

Albana Vokshi – The amerikan, kurse këtu e ke të vendeve të BE-së. Nuk ka asnjë vend të BE-së që ka këtë lloj shkolle...

Lindita Nikolla – Shko në Slloveni dhe do ta gjesh!

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – E kuptoj se keni sjellë një projektligj për ta politizuar edhe atë pjesë që ju ka mbetur, t’i jepni dermën ...

Nuk dhe asnjë përgjigje. Ku e keni gjetur modelin që hiqni inspektoratin? Këtë nuk e kuptoj! Ai mezi u bë, edhe me financim të BE-së. Ishte një investim i mirë që ua trashëguam, por e prishët edhe atë, tani po hiqni edhe inspektoratin...

(Diskutime pa mikrofon.)

Nëse modelin e keni anglo-sakson, ku e gjeni këtë?! Keni hequr nenin...

Lindita Nikolla – Nuk e heqim inspektoratin...

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Mos bëj të habiturën, por merr lexo pak para se të vish këtu...

A doni t’jua them unë? I kam të gjitha vendet e BE-së këtu. Jua jap të gjitha, se vini të papërgatitur. Merrni dhe lexojini! Po flas për inspektorin...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ne i lexojmë para se të vijmë këtu, se jemi seriozisht të përgatitur. Ja ku e keni modelin holandez, norvegjez! Këtu i keni të gjitha modelet. Nuk ka model si ky që ju keni sjellë. Ky model shkatërron çdo gjë. Kini kujdes! S’po e bëni për ne, arsimi nuk është për ne. Nuk mund të bëni një amalgamë dhe të krijoni një superagjenci që është edhe mbi ministren.

A e kuptoni se çfarë po bëni?! Kjo është një gjë skandaloze! Mos e bëni për ne! Ne po ju japim një sugjerim. Është gabim total. Nuk ka model si ky që ju po propozoni dhe ju lutem përgjigjet për tekstet shkollore, se për të tjerat...

Lindita Nikolla – Në VKM janë shteruar të gjitha përgjigjet e pyetjeve që thamë, janë tekste në përdorim, nxënësit do t’i marrin falas dhe patjetër që do t’i trajtojmë siç trajtohet një libër, me shumë kujdes, për ta dorëzuar në fund të vitit shkollor. Në rast se nuk e dorëzojnë në kushtet për t’u përdorur, sërish nga nxënësi i vitit pasardhës, patjetër që do të blejnë tekste të tjera dhe nuk do t’i marrin më falas.

Albana Vokshi – Pra, është mashtrim kokë e këmbë ajo që keni thënë. Nuk ka tekste falas, sepse si mundet t’i kërkohet një fëmijë të klasës së parë, të dytë apo të tretë të mos shkarravisë librin? A keni fëmijë ju, apo nuk keni? Çfarë do të thotë kjo? Ja qëlloi që e grisi, do të penalizoni prindërit? Ju këtë idenë e teksteve falas e keni një mashtrim kokë e këmbë. Ju po gjobisni prindërit.

Lindita Nikolla – Shkolla është edhe institucion edukues. Rrini e qetë se fëmijët e kanë të mjaftueshme kulturën.

Albana Vokshi – Të përdoren librat shkollorë për tri vjet, apo të detyroni fëmijët që, nëse e shkarravisin librin, nuk do të marrin ose do të paguajnë librat, është një skandal i madh. Jo vetëm që nuk është falas, por ju po i penalizoni për herë të dytë e të tretë. Edhe ajo politika që e vodhët përgjysmë, qenka një mashtrim kokë e këmbë! Është e tmerrshme kjo që po bëni, ju thoni se po ua jepni falas, por ju po vidhni.

Lindta Nikolla – Vendet që e bëjnë këtë i kanë fëmijët më pak të shtrenjtë se ne?

Albana Vokshi – Shpjegojuani të gjithëve se nuk ka libra falas. Të përdoret tri vjet një libër, ku e keni gjetur këtë ju?!

Lindta Nikolla – Vendet që e bëjnë këtë i kanë fëmijët më pak të shtrenjtë se ne?

Albana Vokshi – Atëherë, zonja Ministre shumë mirë që e shpjeguat këtë, bravo ju qoftë! Mashtrimi i fundit është skandaloz. Nuk është për të qeshur, se është e turpshme të mashtroni familjet, duke u thënë se po u jepni tekste falas. Është e turpshme dhe do ta përsëris 100 herë. Turp për këtë që po bëni, pra të mashtroni qindra e mijëra familje se gjoja po u jepni tekste falas! Sqarojini njerëzit dhe familjet se do t'ju kthehet dyfish e trefish kostoja e atyre që po thoni sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel, nuk të shqetëson ty fakti që nuk është falas ajo që ti e ke shkruar “falas”? Dil e thuajti nxënësit të klasës së parë “prit, se po e shkarravite pak, do ta paguash dhe nuk ke për të marrë më tekste falas”. A është ky penalitet për prindërit? Çfarë politike është kjo “falas”, se vetëm falas nuk është?!

Rri, ore Ilir, se po na e bëni si *check-up*-i falas, edhe këtë na e bëni ta paguajmë 100 herë më shumë.

Zonja Mehmetaj, keni fjalën në emër të grupit të LSI-së.

Kejdi Mehmetaj – Siç e parashtruam edhe në diskutimet që bëmë me zonjën ministre, nuk morëm asnjë përgjigje për 80% të pyetjeve që ngritëm, por mbase nuk duhej të prisnim ndonjë përgjigje. Ne shprehim shqetësimin e madh që, nëpërmjet ndryshimeve që po bëhen me këtë ligj, në fakt po kërkohet të legjitimohen procedurat e paligjshme, që janë ndjekur në ligjet e mëparshme. Për këtë ne shprehim qëndrimin tonë kundër ndryshimeve.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Ne, si grupi i PS-së, themi që projektligji, që ka ardhur për t'u diskutuar, i shërben shumë mirë mënyrës se si reforma në arsim po shtrihet edhe në sistemin parauniversitar. Në vendosëm qysh dje që ta fusnim në kalendar dhe ramë dakord që ky projektligj kërkon

vëmendje gjatë kësaj legjislature. Ndërkohë ndryshimet e paraqitura në këtë projektligj, të një ligji të ndryshuar, në fakt ndihmojnë më shumë disa elemente që kanë nevojë të ndjekin arsim parauniversitar në Shqipëri. Së pari, platforma “Mësues për Shqipërinë”, e cila ka të bëjë me kompetencën dhe me preferencën, shërben si një instrument për të vendosur barazi mbi aftësinë që kanë mësuesit.

Nga ana tjetër, është e rëndësishme që ne të kemi njohuri të vazhdueshme për nxënien e nxënësve. Kështu që vlerësimi që bëhet me skema nga jashtë për nxënien, që kanë nxënësit në arsimin parauniversitar, i gërshetuar edhe me matje të nxënies në mënyrë të pavarur, është shumë i rëndësishëm.

Ne mendojmë se shkolla e drejtorëve është një instrument i ri, që ka të paktën që nga viti 2001 që kërkohet të vendoset në sistemin tonë arsimor parauniversitar dhe, më në fund, pas 18 vjetëve përpjekje, ne vendosëm që shkolla e drejtorëve të jetë një instrument për mirëmenaxhimin e shkollës.

Gjithashtu, është edhe vendosja e komiteteve rajonale, ku ne kuptojmë që arsimi është një çështje që i përket komunitetit. Pjesëmarrja e Këshillit Prindëror në këto komitete rajonale është shumë e rëndësishme, sepse e bën komunitetin të përgjegjshëm për cilësinë e arsimit që ofrohet në rajon.

Ajo që kemi vënë re në arsim këto kohë është se për disa degë shkencore, si matematika, fizika dhe histori-geografia, kemi pasur mungesa të kapaciteteve. Fakti që tani po japim një mundësi tjetër që, ata që kanë mbaruar degën fizikë, matematikë apo histori, por nuk kanë aftësi pedagogjike dhe kanë nevojë t’i shtojnë për të hyrë në sistemin e dhënies së dijeve, që vjen më këtë ligj, është një ngjarje shumë e rëndësishme edhe për të mbuluar nevojat që kemi për arsimin në të gjithë territorin e Shqipërisë. Vlen të theksohet që për herë të parë kemi një mbështetje për gjuhën *braj* të nxënësve më aftësi të kufizuara, e cila është marrë në konsideratë edhe për sa i takon buxhetit. Në projektrelacion ju keni parë që ka një vlerësim të buxhetit për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Një tjetër gjë e rëndësishme që dua të sjell në vëmendjen tuaj, është krijimi i Regjistrat Shtetëror të Mësuesve për të ndjekur nxënësit që janë në diasporë dhe kanë nevojë për të mësuar gjuhën dhe kulturën shqipe.

Mendoj se këto ndryshime që vijnë në këtë projektligj, të paktën në linja të përgjithshme, çojnë përpara reformën që kemi ndërmarrë në sistemin arsimor. Ka disa gjëra që nesër, në

diskutimet nen për nen, por edhe nga diskutimet që u bënë sot, do të kenë nevojë të shihen pak më me vëmendje, sepse mund të jetë e nevojshme që nene të caktuara të marrin një formë tjetër. Sikurse tha zonja Duka, këtu ka nevojë për një gjuhë teknike më të përmirësuar, ashtu siç dhe ne ngritëm disa shqetësime që lidhen me mënyrën si funksionojnë këto institucione të arsimit të lartë në territor. Unë besoj se diskutimet e sotme ishin të mjaftueshme për sot, por do të vlejnë edhe për nesër, sepse edhe nesër do të ketë nevojë që, në diskutimet nen për nen, të jemi të përqendruar në gjërat e rëndësishme për të çuar përpara reformën arsimore në Shqipëri. Duke thënë këto, besoj se shpreh edhe mendimin e kolegëve të maxhorancës. Të mos harrojmë se cilësia e arsimit në Shqipëri është në vazhdim dhe fakti që kemi këtë ligj të arsimit parauniversitar, ka një ndikim nga ligji i arsimit të lartë, i cili sjell disa gjëra për ndryshim në ligjin e sistemit parauniversitar në Shqipëri.

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja Ekonomi!

PD-ja është kundër në parim me këtë projektligj, sepse nuk i shërben atij qëllimi. Unë mendoj se kemi kaq orë që flasim për një çështje sensitive si për fëmijët tuaj, ashtu dhe fëmijët tanë, ndaj nuk ka vend për shaka këtu dhe unë nuk e kuptoj fare se si mund të qeshni në këtë orë të drekës me ato që flet opozita. Ne kemi marrë të gjitha modelet dhe i kemi studiuar të gjitha para se të vinim këtu, kurse ju nuk keni marrë asnjë, dhe jemi më se seriozë në studimin që i kemi bërë projektligjit. Të gjitha diskutimet janë bërë për çdo nen dhe jo vetëm, është analizuar dhe zbërthyer çdo nen, por janë bërë edhe propozimet përkatëse. Është për të qeshur fakti që ministrja as relacionin që ka sjellë nuk e ka lexuar, sepse tjetër modeli i referohet gojarisht dhe tjetër modeli në relacion. Në fakt, nuk ka asnjë model ku mund të bazojë atë që na kanë sjellë me anë të këtij projektligji. Jemi kundër, sepse përtej dhjetëra problemeve të shkaktuara nën drejtimin e kësaj Ministrie nga ministrja Nikolla, që nuk e di se ku iku...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duhej të kishte lajmëruar, sepse po flasim në parim dhe ky është momenti më i rëndësishëm. Nëse është aty, le ta presim që të dëgjojë mendimin e opozitës, përndryshe për çfarë folëm kaq orë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk i interesoka ministres opinioni i opozitës? Është përmbledhja e gjithçkaje që thamë deri tani.

Valbona Shujaku – Po mbajmë shënime dhe do t'ia tregojmë të gjitha me detaje.

Albana Vokshi – Do t’ia tregoni ju?

Valbona Shujaku – Po.

Albana Vokshi – Dakord, faleminderit shumë!

Tani jemi duke folur në emër të grupeve dhe nuk mund të ndërhyri. Ta kishit kërkuar fjalën më përpara!

Deri tani kemi shprehur shqetësimet tona për një sërë problematikash, që janë krijuar nga të gjitha politikat që ka ndërmarrë kjo ministri nën drejtimin e ministres. Kemi denoncuar në prokurori shkeljen flagrante që i është bërë ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, e cila është drejtuar nga ministria me urdhër të Kryeministrit për mbledhjen e të dhënave personale të prindërve të fëmijëve, që përbëjnë rreth 70% të votuesve.

Gjithashtu, problematikë tjetër është edhe zhvillimi i pyetësorëve me përmbajtje krejtësisht të papërshtatshme për moshën dhe zhvillimin normal të fëmijëve, gjë që e ngriti profesori, por edhe zonja Duka. Folëm për tekstet shkollore, që lënë shumë për të dëshiruar për mënyrën e hartimit dhe se çfarë transmetojnë te nxënësit, për firmosjen e kontratës kolektive, e cila zgjati dy vjet, duke tejkaluar të gjitha afatet dhe duke krijuar ankth the pasiguri për rreth 34 mijë mësues, për problemet që lidhen me maturën shtetërore, eksperimentimi i nismës “3 lëndë në 6 orë”, e cila është një dështim, për rastet e përsëritura të dhunës në shkollë (as prania e policit në shkollë nuk ka ndihmuar në uljen e rasteve të dhunës në shkollë) dhe për braktisjen gjithnjë e më të madhe të shkollave. Me aq informacion sa kemi, këtë vit braktisja do të jetë në përqindje akoma më të lartë se ajo që ka raportuar vetë Ministria e Arsimit vitin e kaluar. U përmend edhe nga deputetët e tjerë që buxheti i arsimit vazhdon të jetë shumë i ulët, mosshpërndarja e dëftesave është gjithashtu problem dhe arsimit mesëm profesional ka humbur diku në organikën e tejmbushur të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, dhe nuk duket se ka ndonjë përmirësim. Kjo shërben për të kuptuar që sistemi arsimor parauniversitar vuan nga një shumëllojshmëri problemesh në mënyrën e organizimit dhe të funksionimit. Këto ndryshime ligjore të propozuara sot, në vend që të ofrojnë zgjidhje, krijojnë mundësi për një përkeqësim të cilësisë dhe të funksionimit të arsimit parauniversitar. Koha që ju vutë në dispozicion për diskutimin e këtij projektligji është shumë e shkurtër, duke mos lejuar të bëhen diskutime edhe më të zgjeruara, për të trajtuar të gjitha problematikat, si gjithmonë kur ka projektligje shumë të rëndësishme.

Për të gjitha këto arsye dhe për të tjera që përmendën kolegët e mi në diskutimet e tyre, vota e PD-së është kundër.

E hedhim në votim projektligjin në parim.

Kush është pro? 10.7 kundër. 1 abstenim.

Miratohet.

Nesër në orën 10:00 kemi të ftuar për dëgjuesë përfaqësues nga shoqëria civile. I lutem ministres apo zëvendësministres dhe stafit të ministrisë, sepse stafi duhet të jetë patjetër, të jenë prezent nesër.

Faleminderit!

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA